



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna Drenasit
Municipality Drenas
Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/01-29764 dt. 21/07/ 2026

Në bazë të nenit 40,43 të Ligjit nr. 03/L-40 për vetëqeverisje Lokale, neni 36,41 dhe 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit (Glllogocit), neni 3 pika 3.7 si dhe neni 12 pika 12.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Drenasit

Th ë r r e t

mbledhjen e **rregullt** të Kuvendit Komunal, e cila do të mbahet më datë: 30.07.2026 e cila do të fillojë në orën 10:00.

Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës Drenasit.

Për mbledhje propozohet ky:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Kuvendit Komunal i mbajtur me datë: 29.06.2026
2. Raporti i punës së Kryetarit dhe qeverisjes Lokale Janar-Qershor 2026.
3. Raporti Financiar Janar-Qershor 2026.
4. Të ndryshme

Drenas, 21.07.2026



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Burim Bajupi



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/04-29780 dt. 21/07 2026

PROCESVERBAL

I mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit, mbajtur më 29.06.2026, e cila filloi në orën 10:00.

Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi, i cili deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 26 anëtarë.

Në mbledhje morën pjesë: Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, anëtarët e Kuvendit: Ekrem Elshani (PDKRLL), Naim Gjeli (PDKRLL), Anjeza Kurtaj (PDKRLL), Selman Qallapeku (PDKRLL), Valdet Curri (PDKRLL), Gani Krasniqi (PDKRLL), Erblinë Morina (PDKRLL), Fitore Morina-Hoxha (PDKRLL), Edon Nishori (PDKRLL), Driton Ajazi (PDK), Arigon Sinani (PDK), Jahir Hajdari (PDK), Mërgim Pirraku (PDK), Zeqir Hasi (PDK), Muhamet Xhemajlaj (PDK), Artian Krasniqi (PDK), Pajtime Berisha (PDK), Luljeta Elshani (PDK), Tringa Bujupi (PDK), Egzona Tërdevci (VV), Xhavit Drenori (GREEN), Arbër Halilaj (BD), Mehedin Salihu (Për Drenas e për Kosovë), Egzon Qorri (PDK) dhe Liman Krasniqi (NISMA).

Munguan: Qëndresë Xhema (PDKRLL).

Të pranishëm ishin edhe: Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, nënkryetari Arben Shala, stafi i Zyrës së Kryetarit, drejtorët e drejtorive komunale dhe kryeshefi i KRM "Pastrimi".

Rend i ditës:

1. Procesverbali i mbledhjes së Kuvendit Komunal, mbajtur më 29.05.2026;
2. Draft-Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2027-2029;
3. Raporti i KRU "Prishtina", dega në Drenas;
4. Raporti nga kryeshefi i KRM "Pastrimi";
5. Raport për menaxhimin e pronave komunale të dhëna në shfrytëzim;
6. Informim i Kuvendit Komunal për aktivitetet e KKSBB-së për periudhën janar-qershor 2026;
7. Propozim-vendim për shfuqizimin e Vendimit 02 nr.020/04-19807 të dt. 29.05.2026 për themelimin e komisionit për verifikimin e lejeve ndërtimore nga viti 2017 e deri në vitin 2026;
8. Propozim-vendim për financimin e projektit të OJQ "Klubi i Futbollit FC Feronikeli74";
9. Propozim-vendim për financimin e projektit të OJQ "Klubi KFF Feronikeli" Femra;
10. Propozim-vendim për financimin e projektit të OJQ "Klubi i Futsallit FC "Liqeni";
11. Propozim-vendim për financimin e projektit të OJQ "Shotë Galica";
12. Propozim-vendim për financimin e projektit të OJQ "Klubi i volejbollit Gryka"
13. Propozim-vendim për financimin e projektit të OJQ KV "Feronikeli Femrat";
14. Propozim-vendim për financimin e projektit të OJQ KV "Feronikeli Meshkujt";
15. Propozim-vendim për financimin e projektit të OJQ "Klubi i Futsallit Drenasi";
16. Propozim-vendim për financimin e projektit të OJQ "Klubi i Futsallit Komorani";
17. Të ndryshme.

Egzona Tërdevci tha se, në mbledhjen e KPF-së kemi diskutuar që duhet të kemi një raport të shkruar nga KRM "Pastrimi". Ne si komunë jemi aksionarë në këtë ndërmarrje dhe nuk e di se çfarë do të raportojë kryeshefi nëse ne nuk kemi një raport paraprak për të ditur se çfarë do të diskutojmë. Gjithashtu, sa u përket subvencioneve edhe ju vetë keni kërkuar në komitete që të ketë një raport financiar për vitin e kaluar se ku i kanë shpenzuar mjetet që kanë marrë nga komuna.

Ekrem Elshani, propozon si pikë shtesë për përfshirje në rendin e ditës. **Propozim-vendim për ndarjen e lokacionit në parcelën nr.00523-2 për investime në infrastrukturën sportive, dedikuar për sportin e shigjetarisë.**

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci sqaroi se, ky është një propozim-vendim që e ka kërkuar Ministria e Sportit për të investuar në infrastrukturën e shigjetarisë. Ne e ofrojmë parcelën ku kemi stadiumin sintetik në Zabel.

Zeqir Hasi tha se, dua të di nëse kjo parcelë është në kuadër të investimeve për Lojërat Mesdhetare 2030. Nëse është në shërbim të tyre, unë mendoj që duhet ta shtyjmë për më tej.

Liman Krasniqi, kërkon që kjo pikë vetëm të futet në rendin e ditës për diskutim. Pasi pika të përfshihet në rend të ditës, subjektet përkatëse do të bëjnë arsyetimin për këtë pronë, duke pasur parasysh lojërat që do të mbahen, dhe pastaj Kuvendi do të marrë vendim.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, e hodhi në votim pikën shtesë. **Propozim-vendim për ndarjen e lokacionit në parcelën nr. 00523-2 për investime në infrastrukturën sportive, dedikuar për sportin e shigjetarisë.** Pika kaloi me 23 vota për, 1 kundër dhe 1 abstenim.

Arigon Sinani tha se, unë mendoj që pika shtatë, **Propozim-vendim për shfuqizimin e Vendimit 02 nr.020/04-19807 të dt.29.05.2026 për themelimin e komisionit për verifikimin e lejeve ndërtimore nga viti 2017 e deri në vitin 2026**, duhet të hiqet nga pikat e rendit të ditës. Me sa e kuptova vendimin e kthyer nga MAPL-ja, ministria thotë që nuk është kompetente dhe këtë kompetencë ia ka kaluar Kuvendit.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci theksoi se, kjo pikë e rendit të ditës është miratuar dhe votuar nga Kuvendi edhe me kërkesën e tij. Ne e kemi obligim të marrim ligjshmërinë. MAPL-ja ka thënë se është në kundërshtim me ligjin që Kuvendi të kontrollojë komunën duke formuar komision hetimor. Ne detyrohemi ta shfuqizojmë për këtë arsye, sepse përndryshe humbim pikë në Grantin e Performancës.

Egzona Tërdevci theksoi se, për korrektësi, Kuvendi e ka vendimin dhe aty nuk thuhet se është në kundërshtim me ligjin, por vetëm se nuk hyn në fushëveprimtarinë e Ministrisë së Mjedisit, ku e kishte adresuar MAPL-ja. Por nëse doni të shfuqizoni, atëherë propozoj një pikë të re që nuk i nënshtrohet ligjshmërisë, formimin e të njëjtit komision që u kërkuar nga kolegu Arigon Sinani.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci tha se, kjo është e njëjta pikë sikur ajo e komisionit rekomandues për pronat. Pra, mund të marrim çfarëdo vendimi, por tani kjo çështje është vetëm në kompetencën tij. Unë jam dhe kam qenë pro, nuk e kam atë problem dhe mund ta kontrolloj. Mirëpo, këtë çështje mund ta kontrollojë vetëm Prokuroria. Ju e keni mundësinë për qasje në dokumente dhe mund t'i dërgoni ato në Prokurori.

Xhavit Drenori theksoi se, për sa i përket pikës shtatë, një situatë e tillë është trajtuar edhe në mbledhjen e kaluar, ku u vendos ndryshimi i emërimit që të mos kishte nevojë t'i nënshtrohej ligjshmërisë. Ai shprehu shqetësimin e tij lidhur me Grantin e Performancës që përmendi kryetari, duke shtuar se nëse shfuqizimi bëhet për këtë arsye, atëherë duhet gjetur një zgjidhje për funksionalizimin e një komisioni të tillë. Ai potencoi se propozuesi e ka parë të rrugës dhe janë pajtuar që ka nevojë për këtë komision, prandaj duhet gjetur një zgjidhje për një propozim të ri dhe jo të bëhet anulimi i plotë.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, theksoi se, nëse ky akt nuk shfuqizohet, komuna do t'i humbë tri pikë, duke specifikuar se po flet vetëm për këtë çështje.

Arigon Sinani theksoi se, ndonëse është deklaruar që qasja në dokumente zyrtare mund të kërkohej përmes e-mail-it, ai ka bërë kërkesë disa herë pikërisht për pronat, por nuk i janë ofruar dokumentet e kërkuara. Ai shtoi se kjo është edhe ideja e formimit të këtij komisioni, pasi zyrtarët kanë hezituuar të kthejnë dokumentet e kërkuara ku dihet se ka shkelje, andaj kërkoi që kjo pikë të hiqet nga rendi i ditës.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, hodhi në votim rendin e ditës së bashku me pikën shtesë. **Propozim-vendimin për ndarjen e lokacionit në parcelën nr. 00523-2 për investime në infrastrukturën sportive, dedikuar sportit të shigjetarisë.** Kryesuesi konstatoi se në mbledhje ishin të pranishëm 26 anëtarë. Pas numërimit të votave, rendi i ditës u miratua me 23 vota për, 1 kundër dhe 2 abstenime.

Rendi i ditës:

1. Procesverbali i mbledhjes së Kuvendit Komunal, mbajtur me dt.29.05.2026;
2. Draft-Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2027-2029;
3. Raporti i KRU "Prishtina", dega në Drenas;
4. Raporti nga kryeshefi i KRM "Pastrimi";
5. Raport për menaxhimin e pronave komunale të dhëna në shfrytëzim;
6. Informim i Kuvendit Komunal për aktivitetet e KKS-së për periudhën janar-qershor 2026;
7. Propozim-vendim për shfuqizimin e Vendimit 02 nr.020/04-19807 të dt. 29.05.2026 për themelimin e komisionit për verifikimin e lejeve ndërtimore nga viti 2017 e deri në vitin 2026;
8. Propozim-vendim për financimin e projektit të OJQ "Klubi i Futbollit FC Feronikeli 74";
9. Propozim-vendim për financimin e projektit të OJQ "Klubi KFF Feronikeli" Femra;
10. Propozim-vendim për financimin e projektit të OJQ "Klubi i Futsallit FC "Liqeni";
11. Propozim-vendim për financimin e projektit të OJQ "Shotë Galica";
12. Propozim-vendim për financimin e projektit të OJQ "Klubi i Volejbollit Gryka"
13. Propozim-vendim për financimin e projektit të OJQ KV "Feronikeli Femrat";
14. Propozim-vendim për financimin e projektit të OJQ KV "Feronikeli Meshkujt";
15. Propozim-vendim për financimin e projektit të OJQ "Klubi i Futsallit Drenasi";
16. Propozim-vendim për financimin e projektit të OJQ "Klubi i Futsallit Komorani";
17. Propozim-vendim për ndarjen e lokacionit në parcelën nr. 00523-2, për investime në infrastrukturën sportive, dedikuar për sportin e shigjetarisë;
18. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës.

Pika (1): Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kuvendit Komunal të dt. 29.05.2026.

Pasi konstatoi se nuk ka diskutime nga anëtarët e Kuvendit, kryesuesi e hodhi në votim pikën e parë. Pas numërimit të votave, procesverbali u miratua me 24 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës.

Pika (2): Draft-Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2027–2029.

Egzona Tërdevci theksoi se, i kam disa çështje për diskutim të kjo pikë. E para është grumbullimi i projekteve, drejtori në KPF tha se do të na sjellë një listë se ku do të orientohen investimet, sepse në PIP kanë thënë që nuk mund t'i regjistrojnë gjatë projektit. Në faqen 9 të Draft-Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale 2027–2029 janë paraparë 42 punonjës të

sektorit parafillor të arsimit, a i mbulon kjo nevojat, pasi që do të ndërtohen edhe dy çerdhe të reja, si në Arllat dhe në Llapushnik. Të programi i arsimit ka ndërtesa arsimore dhe fusha sportive, por nuk janë të caktuara vendet. Për rrethoja të objekteve sportive janë paraparë 120 mijë euro, që më duket e paarsyeshme t'i rrethosh objektet sportive publike, cila është arsyeja e këtij planifikimi. Edhe të shëndetësia është paraparë ndërtimi i QMF-së, por nuk ceket vendi ku do të ndërtohet. Gjithashtu, kisha propozuar të parashihet një kod për përmbarim, me qëllim që të mos preken projektet.

Drejtori i Arsimit, Muhamet Gjoka theksoi se, lidhur me kërkesën për numrin e stafit, në vazhdimësi dërgojmë kërkesa në bazë të nevojave dhe e kemi të qartë planifikimin, ashtu si edhe objektet që mendojmë t'i funksionalizojmë.

Drejtori i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Alban Zogaj theksoi se, objektet sportive kanë një hapësirë të madhe dhe për shkak të sigurisë e kemi paraparë të ketë rrethoja, sepse mund të futen njerëz që mund të sjellin probleme. Në qarkoren e parë janë kërkesat fillestare që përcaktojnë vetëm kufijtë, ndërsa në qarkoren e dytë vijnë specifikat dhe lista e projekteve nëpër secilën shkollë. Nëse dëshironi ta dini lokacionin se për cilën shkollë bëhet fjalë, bëhet fjalë për shkollën në Shtrubullovë.

Drejtori i Infrastrukturës, Endrit Gllareva sqaroi se, lidhur me specifikimin e projekteve, sistemi PIP nuk pranon shumë karaktere apo shkronja, ashtu siç u përmend edhe gjatë diskutimit.

Drejtoresha e Shëndetësisë, Kaltrina Qerkinaj njoftoi se, ndërtimi i Qendrës së Mjekësisë Familjare (QMF) do të bëhet në fshatin Arllat.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, theksoi për shpenzimet e përmbarimit në mund të ndajmë buxhet, por më tregoni se cilin buxhet të ndajmë për atë çështje. Nëse Qeveria na i merr përmes përmbaruesit mjetet për kontratën që vetë e ka lidhur, në nuk mund të ndajmë buxhet. Nëse ndajmë, i bie të mos investojmë asgjë në komunën e Drenasit, sepse nuk kemi më shumë buxhet.

Driton Ajazi, theksoi se ka analizuar Draft-Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale 2027–2029. Nga raportet e drejtorëve, ai vuri re se në qarkoren e dytë jepen projektet dhe orientimi i tyre. Fokusi i tij është për fshatin Sankoc dhe për dy Fushticat, ku është paraparë vlera prej 50 mijë eurosh, që sipas tij është një vlerë e ultë. Ai shtoi se, e ka cekur edhe më herët që banorët e këtyre fshatrave e kanë shumë të nevojshme ndërtimin e trotuarit përgjatë rrugës "Fazli Grajçevci". Një kërkesë tjetër, siç tha ai, është edhe rritja e kapaciteteve të ujësjellësit ekzistues në Sankoc, i cili është nën juridiksionin e KRU "Prishtina". Ai theksoi se, aty gjendet një burim që quhet "Spac", i cili ka ujë të mjaftueshëm, por nevojitet vetëm një investim për t'i rritur kapacitetet, duke i cilësuar këto dy kërkesa si prioritare.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci tha se, është në dorën e këshilltarëve të votojnë buxhetin si të duan dhe ku të duan. Por, sa i përket trotuarit, ai theksoi se u ka thënë qytetarëve që të identifikojnë përmes kadastrës se ku mund të vendoset trotuari, në mënyrë që të mos preket pronë private.

Edon Nishori, kërkoi që të bëhet mirëmbajtja dhe zgjerimi i trotuareve. Ai theksoi se këtë e ka kërkesë nga banorët e katër Komoraneve. **Te lagjja „Lagja e Re“** trotuari ka mbetur në gjysmë, ndërsa në „Komoran 2“ të gjitha pronat janë shpronësuar dhe rregullimi i tyre është në të mirë të të gjithë qytetarëve.

Xhavit Drenori tha se, ka dy çështje për të ngritur. E para, ai theksoi se janë duke themeluar një ndërmarrje publike komunale që do të ketë kosto dhe dëshironte të dinte nëse gjatë këtyre tre vjetëve do të ketë buxhet të caktuar specifikisht për këtë kompani. E dyta, ai tha se, është zotuar para qytetarëve për formimin e komisioneve në Kuvend, sepse problemi qëndron te mungesa e informacioneve. Ligji e ka paraparë që anëtarët e Kuvendit kanë të drejtë të formojnë komisione apo grupe joformale, gjë që nuk e pengon askënd. Qëllimi i këtyre grupeve, nuk është zënia ngushtë e ndonjë drejtorie, por fillimisht organizimi i vetë këshilltarëve dhe më pas ndihma ndaj ekzekutivit, pasi në fund vendimet merren nga Kuvendi. Ai shtoi se, një vendim pa informacion është nonsens, prandaj duhet t'i kthehen çështjes së aktivizimit të kolegëve, pasi aktivizimi bëhet përmes temave të tilla.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, tha se, në vitin tjetër janë të detyruar të ndajnë buxhet për kompaninë, sepse pa u themeluar ajo nuk mund të ndahet buxhet. Sa i përket komisioneve, ai theksoi se, nuk i kanë ndaluar kurrë që t'i bëjnë.

Mehedin Salihu tha se, ka një pyetje për drejtorin e Arsimit, pasi nuk e ka parë askund të paraparë klimatizimin e shkollave, duke theksuar se, nevojitet edhe ky rekomandim. Drejtoreshës së Shëndetësisë i tha se, e mirëpret ndërtimin e Qendrës së Mjekësisë Familjare (QMF), por ngriti edhe çështje të tjera. Ai theksoi se, në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) ashensori nuk punon prej vitesh, gjë që paraqet vështirësi për gratë shtatzëna që kryejnë shërbime gjinekologjike. Po ashtu gjendja e tualeteve është alarmante. Ai pyeti gjithashtu se pse në Shërbimin e Urgjencës në Komoran nuk ekziston një numër thirrjeje (telefoni), ku qytetarët mund të kontaktojnë ekipin e qendrës.

Kryetari i komunës, Ramiz Lladrovci, tha se klimatizimi nuk bëhet në shkolla, sepse gjatë verës ato nuk punojnë, por kur të ekzistojnë mundësitë, do të bëhet. Për tualetet, ai theksoi se Mehedin Salihu ka të drejtë, megjithëse është investuar disa herë dhe gjendja mbetet e njëjtë. Për numrin e emergjencës në Komoran, ai tha se nuk e dinte që duhet të ketë numër të veçantë në Komoran dhe në Drenas, pasi qytetarët thërrasin në një numër të vetëm pastaj i orientojnë.

Mehedin Salihu tha se, është e vërtetë që nuk mund të bëhet klimatizimi në të gjitha shkollat, por në shkollën „Rasim Kiçina“ ka ngarkesë shumë të madhe dhe kostoja nuk është e lartë. Ai theksoi se, nuk mund t'i lënë qytetarët me shpresë vetëm sepse do të ndërtohet QKMF-ja e re.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, sqaroi se numri i lindjeve në repartin e gjinekologjisë është shumë i vogël, rreth një deri në dy gjatë një viti, andaj ashensori i ri është paraparë të vendoset në objektin e ri. Sa i përket shkollës „Rasim Kiçina“, ai theksoi se jemi duke ndërtuar shkollën në Shtubullovë, projekt ky që do të zvogëlojë numrin e nxënësve dhe do të mundësojë kalimin e procesit mësimor në vetëm një ndërrim.

Xhavit Drenori tha se, për informatë, qeveria gjermane nuk lejon vendosjen e asnjë klimatizuesi brenda objektit, pasi ata e dinë që klimatizuesit kanë edhe efekte anësore negative. Prandaj, para se të bëhet klimatizimi, do të ishte mirë të merrej një leje nga Ministria e Arsimit për të parë nëse lejohet dhe cilat janë standardet, sepse nuk mund të vendoset klimatizuesi kudo duke u bërë dëm trupit të fëmijëve, edhe pse ata mund të mos e vërejnë për momentin. Është mirë të shkohet me hapa të sigurt.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, e hodhi në votim pikën e dytë. Për votuan 23, kundër 2 abstenim 1, kjo pikë e rendit të ditës kaloi.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës.
Pika (3): Raporti i KRU "Prishtina", Dega në Drenas.

Nënkryetari i Komunës, Arben Shala tha se, e kanë informuar me kohë kryeshefin e KRU "Prishtina", z. Arsim Fetahu, që të vinte, por ai nuk ka ardhur. Tha se ka biseduar edhe me drejtorin e degës në Drenas, i cili i ka thënë se do të vinte, por nuk e dinte se pse nuk kishte ardhur.

Liman Krasniqi, pyeti nëse ka ndonjë anëtar në bordin e kompanisë së ujësjellësit nga Kuvendi Komunal, pasi theksoi se duhet të jetë një.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci tha se, u kanë dërguar email dhe tha t'u jepet mundësia për t'i prit edhe pak. Ata janë duke e diskriminuar Drenasin me ujë të pijshëm dhe po krijojnë probleme epidemiologjike, andaj nëse shihet e arsyeshme, kjo pikë mund të vendoset si pika e fundit e rendit të ditës.

Egzona Tërdevci tha se, fillimisht do të ishte mirë të dihej nëse vijnë apo nuk vijnë. Nëse nuk vijnë, nuk ka kuptim të lihet si pikë e fundit, por mund të përmbyllet si pikë diskutimi dhe të vazhdohet tutje.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi tha se, në mungesë të kryeshefit të KRU "Prishtina", z. Arsim Fetahu, dhe të drejtorit të degës në Drenas, me aprovimin e asamblistëve (ku 24 ishin për, 0 kundër dhe 1 abstenim), pika e tretë e rendit të ditës zhvendoset si pika e 17-të.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi, hapi për diskutim pikën e katërt të rendit të ditës. **Pika (4): Raporti nga kryeshefi i KRM "Pastrimi".** Fjalën e merr kryeshefi i KRM "Pastrimi", z. Petrit Reçica.

Kryeshefi ekzekutiv i KRM „Pastrimi“ SH.A., Petrit Reçica, tha se ky raport paraqet performancën financiare dhe operacionale të Njesisë Operative - Drenas për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2025 në veçanti, si dhe një përmbledhje të përgjithshme të ndërmarrjes në kuptim të organizimit financiar-operativ. Raporti synon të informojë aksionarin – Komunën e Drenasit – mbi të ardhurat, shpenzimet, sfidat dhe masat e nevojshme për të përmirësuar qëndrueshmërinë financiare të njesisë. Në organizimin e ndërmarrjes, Njësia Operative e Drenasit, si pjesë përbërëse e KRM „Pastrimi“ SH.A., funksionon dhe vepron në shërbim të qytetit të Drenasit. Në

bazë të organogramit, sipas Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës në KRM „Pastrimi“ SH.A., Njësia Operative e Drenasit ka pësuar ndryshime organizative, të cilat në një formë do të mundësojnë qasjen më të lehtë në kryerjen e punëve ditore përmes mundësive që janë përcaktuar me anë të pozitive të reja. Këto pozita kanë qenë të nevojshme, sidomos në sistemin financiar dhe atë operativ. Sipas këtyre ndryshimeve, struktura organizative e njësisë përbëhet nga. Menaxheri i njësisë, përgjegjësi operativ i njësisë, mbikëqyrësi i grumbullimit të mbeturinave, mbikëqyrësi i mirëmbajtjes së hapësirave dhe higjienës publike, kryepunëtorët, mekaniku, axhustatori, salduesi, shoferët, kontrolli intern i njësisë, asistenti administrativ, punëtorët e bartjes dhe higjienës, punëtori i sigurimit/roje, mbikëqyrësi financiar, zyrtari për shpenzime dhe pagesa, inkasantët, arkatarët në portoarkë dhe depoisti. Aktualisht, njësia në nivelin funksional të burimeve njerëzore ka gjithsej 56 punëtorë me kontratë të rregullt pune. Ndryshimet në bazë të rregullores së re për sistematizimin janë bërë me qëllim që të lehtësohet puna në njësi, sidomos në aspektin operativ, duke u paraparë pozitat në mekanikë që kanë të bëjnë me rregullimet e kamionëve. Kjo u mundëson që për prishjet të cilat nuk janë të ndërlikuar apo të natyrës më të rëndë, të mos ketë nevojë që mjetet të dërgohen në autoparkun qendror në Prishtinë, gjë që rezulton me humbje kohe dhe, sigurisht, me kosto më të lartë të shpenzimeve të bartjes. Gjithashtu, është përcaktuar edhe njësia e financave dhe pagesave, e cila në të kaluarën nuk ka ekzistuar, dhe me krijimin e saj është menduar që të lehtësohen punët në kuptim të organizimit financiar, barazimeve financiare dhe pagesave. Ideja bazike e këtyre përcaktimeve ka qenë që t'i paraprihet procesit të filluar të decentralizimit të kostove financiare. Për më gjerësisht, raportin mund ta gjeni në linkun në YouTube të mbledhja e Kuvendit komunal.

<https://www.youtube.com/watch?v=iPB-FbFbAc8>

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci tha se, dua t'i njoftoj qytetarët e komunës së Drenasit se të gjitha veprimet e mbledhjes së mbeturinave në komunën tonë i ka për përgjegjësi kompania „Pastrimi“, e jo Komuna e as kryetari i Drenasit. E falënderoj kryeshefin që ka ardhur për të raportuar. Ashtu siç e cekim edhe kryeshefi, Komuna ka investuar në infrastrukturën e kompanisë për sigurimin e kamionëve të rinj, të kontejnerëve dhe të pajisjeve të tjera përmes buxhetit të Komunës dhe grantit të performancës. Konsumatorët e Drenasit janë ndër më të mirët për pagesat e mbeturinave, por, në të kundërtën, janë konsumatorët më të diskriminuar. Kjo sepse ndodh që mbeturinat e ekonomive familjare të mos merren për tri javë, vëllimi i mbeturinave rritet dhe kompania nuk i merr mbeturinat që janë në qese të zeza jashtë kontejnerit. Ne jemi munduar ta ndihmojmë kompaninë, sepse ata kanë një krizë të madhe financiare. Kemi dhënë kontrata njëburimore vetëm për t'ju ndihmuar, siç janë ato për kositjen e barit dhe për pastrimin e borës. Por, sipas drejtorit të KRM „Pastrimi“, ne do të mbetemi pa shërbim sepse nuk ka zgjedhje tjetër. Unë kërkoj nga kjo kompani që Komunën dhe qytetarët e Drenasit t'i trajtojë barabartë si komunat e tjera.

Xhavit Drenori, e falënderoi kryeshefin e KRM "Pastrimi", Petrit Reqica, që ka ardhur për të raportuar. Por më mirë do të kishte qenë që atë raport të na e dërgonit paraprakisht në e-mail, në mënyrë që ne të kishim informacione më të zgjeruara. Pastaj, ne mund t'u kthejmë përgjigje njerëzve që na shkruajnë dhe na thërrasin, sepse qytetarët presin që t'u ofrojmë alternativa për zgjidhjen e këtij problemi. Ju e përmendët tarifat dhe faturimin minus, që ishte një divergjencë e asaj së psc të hyrat ndryshojnë nga faturimi, dhe kaluat të përmbaruesi. Dua t'ju them diçka, kënaqësinë dhe pakënaqësinë me rezultatet tuaja e ndiejnë vetëm qytetarët përmes shërbimit që u ofrohet. Siç e tha edhe kryetari, nëse kamioni nuk shkon për katër javë për t'ia marrë mbeturinat, kjo gjendje është shumë shqetësuese. Nëse qytetarët janë të obliguar të paguajnë për diçka që nuk e marrin, ata po vidhen dhe këtu është shqetësimi im më i madh. Këtu qëndron problemi me përmbaruesin, sepse nëse një qytetar nuk ka paguar nga inati se nuk ia kanë marrë mbeturinat për katër javë dhe ai dërgohet te përmbaruesi, ai u vodh edhe prej institucioneve shtetërore, jo vetëm prej kompanisë.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci deklaroi se, Komuna i ka përmbushur të gjitha obligimet e saj dhe se hapi i më tutjeshëm mbetet vetëm adresimi i këtyre shqetësimeve, duke propozuar edhe iniciimin e një peticioni me nënshkrime kundër diskriminimit të Komunës.

Xhavit Drenoriai tha se, ju si kryetar dhe ne si anëtarë të Kuvendit jemi këtu për t'u zgjidhur probleme njerëzve. Nëse një problem mbetet i pazgjidhur për një kohë kaq të gjatë dhe ne rrimë duarkryq, atëherë nuk ka dështuar vetëm kompania, por kemi dështuar edhe ne si të zgjedhur të popullit. Ky është halli im. Nuk po ta them ty personalisht, po e them edhe për veten tonë. Por, ideja për të ikur thjesht duke thënë se kjo nuk është përgjegjësi e jona, nuk është gjë e mirë.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, reagoi duke deklaruar se nuk i ka ikur asnjëherë përgjegjësisë dhe se vazhdon të qëndrojë prapa obligimeve të tij.

Mehedin Salihu tha se, e dëgjova me vëmendje raportin por është pothuajse i njëjtë me atë të vitit të kaluar. Me gjithë respektin për praninë tuaj këtu, do t'ju kisha lutur që të dilni dhe t'i vizitoni fizikisht punëtorët tuaj. Ata përballen me mungesë të mjeteve të punës, si dorëza e fshisa, e për kamionët mos të flas se në çfarë gjendjeje të keqe janë. Dua t'ju informoj se punëtorë më të mirë, përkundër moshës dhe sëmundjeve që kanë, sesa këtë pjesë të punëtorëve që i keni në pastrim, nuk gjeni askund. Mirëpo, Drenasin e keni neglizhuar, sepse gjithmonë keni marrë masa vetëm atëherë kur ne e kemi ngritur zërin. Kur ju thoni se nuk ka të interesuar për punë, me ato shifra të rrogave që po përmendni, po kam qejf edhe unë të shkoj e të punoj aty. Të bëhemi pak më realë dhe t'u krijojmë njerëzve kushte për punë, e pastaj të kërkojmë përgjegjësi. Rriteni koston, por përmirësojeni cilësinë.

Driton Ajazi, e falënderoi kryeshefin e KRM 'Pastrimi', Petrit Reqica, që ka ardhur për të raportuar këtu, dua të them se në krye të piramidës së problemeve është uji, e pastaj vjen problemi me mbeturinat. E dëgjova me vëmendje raportimin tuaj. Ju si kompani keni paraparë një plan biznesi në vlerë prej 70 milionë eurosh, i cili është nën jurisdiskicionin e Qeverisë se a ua miraton apo nuk ua miraton. Pastaj janë pajisjet teknike dhe çështjet e tjera. Çështja e mbeturinave në komunën tonë ka qenë shqetësuese, jo vetëm gjatë fushatave, por me vite të tëra, edhe pse qytetarët tanë kanë qenë të përgjegjshëm në kryerjen e pagesave. Është shqetësues fakti

se grumbullimi i mbeturinave gjatë stinës së verës mund të shfaqë ndonjë epidemi, e cila mund të kushtojë edhe me jetë njerëzish. Kam një pyetje: Nëse ky plani prej 70 milionë eurosh nuk aprovohet nga Qeveria, a keni paraparë ndonjë alternativë tjetër. Kontratën që keni bërë për zëvendësimin e operatorëve në rast të defekteve të pajisjeve teknike, a nuk e keni paraparë edhe më herët. Sepse ne si Drenas kemi pasur shumë telashe. Ne si qytetarë të Drenasit, kërkojmë nga ju si kompani që të na specifikoni të gjithë hapat në detaje për mënyrat e veprimit në të ardhmen, në mënyrë që kjo çështje të mos përsëritet gjatë muajve apo viteve në vijim.

Naim Xheli tha se, ekziston një pajtueshmëri e përgjithshme që Komuna e Drenasit e ka mbështetur kompaninë. Ai shton se inkasimi i mjeteve është i rregullt dhe qytetarët tregohen shumë të përgjegjshëm, mirëpo shërbimet ndaj tyre nuk po kryhen. Për këtë arsye, kërkoi nga kryeshefi që të tregojë se sa ankesa janë pranuar, sa investohet në degën e Drenasit nga ky inkasim, si dhe sa automjete janë aktualisht jashtë funksionit. Ai thekson se ka qenë personalisht vizitë në terren dhe ka vërejtur se edhe punëtorët e atjeshëm kanë shumë ankesa. Në fund, ai kërkon të dijë se për sa kohë do të përmirësohet kjo gjendje, me qëllim që më pas të merret një përgjegjësi e qartë.

Edon Nishori, e falënderoi kryeshefin për raportin dhe e pyeti se a është Drenasi pjesë e kësaj kompanie. Ai theksoi se në praktikë kjo prani është pothuajse jockzistente në mënyrën e reagimit të tyre, pasi në asnjë komunë tjetër nuk rrezikohet më shumë shëndetit publik sesa këtu. Ai dëshiroi t'i pyesë se sa është përqindja që do t'i kthehet Komunës së Drenasit me makineri të reja, a do të ketë honorarë për punëtorët që punojnë pas orarit dhe nëse proporcionaliteti i banorëve dhe i pagesave që bëhen në Komunën e Drenasit, në krahasim me komunat e tjera, kthehet në bruto produkt apo në investim konkret. Sipas tij, Komuna e Drenasit dhe qytetarët e saj, si taksapagues të rregullt, meritojnë një trajtim serioz, përgjegjës dhe funksional, në mënyrë që të mos u rrezikohet shëndeti.

Egzona Tërdevci, bëri një pyetje duke thënë se ata i kanë pasur dy përfaqësues nga Kuvendi Komunal edhe në mandatin e kaluar, ashtu siç i kanë edhe tani. Ajo pyeti se cili është angazhimi i tyre, a i sjellin ata kërkesat për Drenasin tek ata dhe a marrin pjesë në ndonjë mbledhje të përbashkët, pasi ata nuk raportojnë kurrë dhe asambleistët nuk e dinë se çfarë bëjnë ata.

Arbër Halilaj, e falënderoi kryeshefin e KRM „Pastrimi“, Petrit Reqica. Ai vuri në dukje se në raport faturimi ishte në nivel më të ulët sesa inkasimi dhe shprehu interesimin për të ditur se si do t'i qaseshin këtij problemi, pasi kjo gjë i afektonte të hyrat. Ai pyeti nëse e konsideronin që vetë faturimi është një kontratë, ku kompania faturon shërbimin dhe qytetari e paguan nëse e merr atë shërbim. Ai u shpreh pro bërjes së një faturimi vëllimor, sepse një qytetar në Prishtinë krijon një sasi më të madhe mbeturinash, ndërsa në Drenas ajo është përgjysmë më e vogël. Sipas tij, këtë çështje do ta kishte zgjidhur faturimi vëllimor. Ai shtoi se Komuna e Drenasit është njëra ndër komunat që i mbështet më së shumti në aspektin operacional në kryerjen e shërbimeve, andaj mbetet të shihet se si do t'i qasen këtij rajoni që u jep mbështetje, pasi ai nuk po shihte që Komuna po merrte diçka në kthim.

Zeqir Hasi, e falënderoi z. Reqicën për raportin. Ai tha se, gjatë prezantimit të raportit kishte dëgjuar që Drenasi dhe Podujeva janë ende me çmime të ngritura për qytetarët. Hasi e pyeti z.

Reqica se sa kohë u duhej atyre që t'i bindnin me shërbime të mira, në mënyrë që ata si Kuvend të votonin për rritjen e çmimit të shërbimeve që bën kompania. Po ashtu, ai kërkoi të dinte se sa është numri i punëtorëve që u mungojnë në kompani, konkretisht në degën e Drenasit.

Ekrem Elshani, e falënderoi kryeshefin e KRM „Pastrimi“, Petrit Reqicën, për raportin dhe pyetjet nëse ka një plan konkret që bizneset në Komunën e Drenasit të ndahen nga ekonomitë familjare. Ai theksoi se, kjo kërkesë vjen për arsye se bizneset po krijojnë një vëllim më të madh të grumbullimit të mbeturinave nëpër kontejnerë.

Kryeshefi i KRM „Pastrimi“, Petrit Reqica, u shpreh se do të mendohej t'i përfshinte pyetjet e ngritura në pesë pika të përgjithshme. Ai theksoi se, ashtu siç e kishte thënë edhe kryetari, kompetenca për grumbullimin e mbeturinave i takon kompanisë „Pastrimi“. Ai bëri të ditur se kishin pasur telashe shumë të mëdha me financat, pasi në Prishtinë për vitin 2025 bilanci kishte qenë zero inkasim dhe se ende po vuanin pasojat. Sipas tij, ky proces kërkon investime dhe një mënyrë më të lehtë inkasimi, gjë që nuk po mundnin ta bënin për shkak të mungesës së mjeteve, ashtu siç nuk kishin mundur të investonin as në kamionë për të njëjtën arsye.

Sa i përket kushteve të punëtorëve, ai sqaroi se ata i kanë të gjitha pajisjet, ndërsa shtoi se nëse nuk i përdorin ato, ata janë përgjegjës të drejtpërdrejt ndaj të cilëve duhet të merren masa. Reqica nënvizoi se nuk ka shërbim cilësor pa mbikëqyrje cilësore, por as pa kosto financiare. Ai deklaroi se kompania nuk i ka vjedhur dhe nuk i vjedh qytetarët. Sipas tij, mungesat në grumbullimin e mbeturinave nuk kanë qenë vetëm në Drenas, por edhe në komunat e tjera, për shkak se u kishin munguar kontratat për mirëmbajtje. Mirëpo, ai siguroi se sot nuk është më ajo gjendje dhe se, bazuar në raportet që marrin, nuk ka më raste që mbeturinat të mos merren për katër javë. Ai shtoi se janë të obliguar të kryejnë shërbim edhe nëse nuk marrin asnjë cent, por faturimi si e hyrë nuk i mbulon shpenzimet e rregullta ditore, duke pasur parasysh numrin e klientëve dhe tarifën ekzistuese. Ai bëri të ditur se nga mosinkasimi në vitin e kaluar kanë pasur një deficit prej minus 120 mijë eurosh, të cilin e kanë mbuluar me një buxhet tjetër, si dhe konfirmoi se i kanë llogaritur e ndara për secilën komunë.

Në fund, kryeshefi hodhi poshtë pretendimet për neglizhencë, duke thënë se thjesht kanë pasur vështirësi, të cilave beson se tashmë ua kanë dalë mbanë. Ai mori përgjegjësinë në emër të kompanisë dhe premtoi se, në kuptim të mbikëqyrjes, nuk do ta linin rehat as njësinë e Drenasit për të gjitha çështjet që u ngritën nga asambleistët parafolës.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, kërkoi nga kryeshefi që të sqarojë situatën për qytetarët. Ai sqaroi se kamioni i cili shkon për zbrazjen e kontejnerëve, nuk ka mundësi teknike t'i marrë mbeturinat e nxjerra me thasë, pasi nuk e posedon sistemin përkatës për ngarkimin e tyre. Për këtë arsye, ai theksoi se nevojitet të ndërmerren dy veprime për të njëjtën punë, duke dërguar kamionë të tjerë ose traktorë. Rrjedhimisht, ai kërkoi që fillimisht të mblidhen me traktor mbeturinat jashtë kontejnerëve dhe pastaj të bëhet zbrazja e tyre. Në fund, ai potencoi se ky është një raport i tremujorit të parë, duke kujtuar se Drenasi deri vitin e kaluar ka qenë kampion për nga shkalla e pagesave, përkundër cilësisë së shërbimit që ka pranuar.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, faleminderit, fjalën e ka z.Petrit Reqica, menaxher i degës së KRM 'Pastrimi' në Drenas.

Menaxheri i degës së KRM „Pastrimi“ në Drenas, Kastriot Berisha, sqaroi se sa u përket shqetësimeve për mosmarrjen e thasëve, ata grumbullohen rregullisht dhe traktori është i destinuar pikërisht për këtë shërbim. Ai theksoi se nuk ka pranuar asnjë ankesë apo kërkesë nga qytetarët për këtë çështje, duke siguruar se mban përgjegjësi të plotë në çdo kohë dhe është në kontakt të vazhdueshëm me terrenin. Po ashtu, ai njoftoi se zyra e tyre funksionon si një njësi e veçantë, me numër 4. Sa i përket vëllimit të punës, ai specifikoi se në qytet grumbullohen rreth 20 tonë mbeturina në baza ditore dhe shërbimi kryhet gjatë natës, ndërsa gjatë javës nëpër fshatra grumbullohen rreth 135 tonë mbeturina. Lidhur me kositjen e barit, ai pranoi se mund të ketë pasur ndonjë ankesë të izoluar, por praktikisht ajo punë është kryer në tërësi. Në fund, ai potencoi se sa herë që kanë pranuar kërkesa nga DSIPE-ja (Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë), punët janë realizuar me sukses, përkundër vështirësive të shfaqura.

Xhavit Drenori, kërkoi ndjesë personale nëse përdorimi i termit „hajni“ është marrë si fyerje personale. Ai sqaroi se kjo çështje ishte shtruar si pyetje, duke ngritur dilemën nëse konsiderohet hajni rrethanë kur qytetarët paguajnë për mbeturinat dhe kamioni nuk i merr ato. Ai potencoi se nuk i ka quajtur zyrtarët hajdutë, por ka konstatuar se një situatë e tillë përbën hajni, pasi në gjuhën shqipe nuk ekziston një term tjetër për të përshkruar rastin kur paguhet për një shërbim, i cili nuk pranohet.

Lidhur me deklaratën se mbeturinat janë mbledhur pas katër javësh, z. Drenori vuri në dukje se ky veprim ndodh me vonesë, atëherë kur qentë endacakë tashmë i kanë shpërndarë ato nëpër lagje të ndryshme. Si pasojë e kësaj vonese, ai theksoi se krijohet kundërmim i rëndë, gjë që vështirëson qarkullimin e lirë të qytetarëve dhe të fëmijëve në ato zona.

Edon Nishori, deklaroi se në Drenas duhet të shtohen kamionët e rinj, gomat rezervë dhe çdo pajisje tjetër e nevojshme për funksionimin e rregullt të shërbimit. Ai propozoi që fillimisht të vendoset një afat kohor për arritjen e një performace të kënaqshme dhe vetëm pas kësaj të sillen si temë diskutimi propozimi për rritjen e tarifës së pagesës për mbeturinat.

Zeqir Hasi potencoi se nuk ka pranuar ende një përgjigje nga z. Reçica lidhur me numrin aktual të punëtorëve që ka kompania dhe se sa punëtorë të tjerë janë të nevojshëm. Sidoqoftë, ai shprehu falënderime për raportin e prezantuar dhe vlerësoi menaxherin si çdo herë korrekt në adresimin e kërkesave të paraqitura.

Kryeshefi i KRM "Pastrimi", Petrit Reçica, bëri të ditur se aktualisht kompania ka rreth 46 punëtorë dhe përballlet me mungesë stafi në sektorin e bartjes dhe të higjienës. Sa u përket shoferëve, ai thekson se numri i tyre është mjaft i ulët, me afërsisht 11 punëtorë. Sipas tij, sfida kryesore mbetet sigurimi i shoferëve për shkak të pagës së ulët, pasi bizneset private po i tërheqin ata duke u ofruar kushte më të mira pune. Po ashtu shtoi se në njësinë e Drenasit janë paraparë të gjithë faktorët e brendshëm për ta bërë këtë njësi të pavarur, siç janë mekaniku, axhustatori dhe depoisti, mirëpo rekrutimi i tyre nuk ka arritur të realizohet si pasojë e pagave të ulëta që kanë pasur deri më tani.

Kryesuesi i Kuvendit, z. Burim Bujupi, deklaroi se seanca shkon në pauzë nga ora 12:40 dhe punimet do të vazhdojnë në orën 14:00 me pikën e radhës.

Kryesuesi i Kuvendit, z. Burim Bujupi, hap për diskutim pikën e pestë të rendit të ditës.

Pika (5). Raporti për menaxhimin e pronave komunale të dhëna në shfrytëzim.

Egzona Tërdevci, lidhur me këtë raport, ngre disa çështje për diskutim duke filluar nga prona e parë e kompanisë "IP-Kos" në Drenas, e cila është dhënë për pompë të derivateve, mirëpo aty operojnë edhe biznese të tjera, gjë që ajo e konsideron shkelje të kontratës. Ajo vë në dukje se operatori "Kroni" nuk e ka përmbushur kriterin e numrit të punëtorëve dhe nuk është i rregullt me pagesa. Tek prona "Thaçi", ajo vëren se në kartelë pagesat figurojnë nga viti 2005 dhe pyet nëse bëhet fjalë për një gabim teknik.

Sa i përket pronës së "ETC"-së në qendër të Komoranit, znj. Tërdevci e quan skandaloze qiranë vjetore që arrin në vetëm 83 euro në muaj. Ajo e krahason këtë me pronën e subjektit "Bekimi" në Komoran, ku në të njëjtën zonë kadastrale çmimi është 2 euro për metër katror, dhe ngre pyetjen se si mund të ketë një dallim kaq të madh për të njëjtin vend. Po ashtu, për këtë biznes ajo thekson se ka ndryshuar pronari dhe konsideron se prona duhej të merrej e të hidhej përsëri në shpallje publike, në vend që të bëhej vetëm një aneks-kontratë.

Për pronën që e ka me qira z. Ragip Veseli, ajo vëren se objekti i kontratës është pronë për derivate, mirëpo i është dhënë dikujt tjetër dhe çmimi prej 6 centësh për metër katror është i pafavorshëm. Ajo shton se të "Autoservis Xhema" nuk është respektuar kriteri për të punësuarit dhe kërkon sqarime se me çfarë kriteresh janë përcaktuar këto çmime. Gjithashtu, ajo thekson se edhe të "IP-Kos" në Arllat është shkelur objekti i kontratës. Për kompaninë "Fer Petrol" në Gllobar, prona është dhënë për qendër edukative për komunikacion, dhe ndonëse është dërguar një shkresë për të ndryshuar objektin e kontratës, znj. Tërdevci vlerëson se prona duhej të jepej nga fillimi, pasi nuk mund të merret për një qëllim dhe pastaj të ndryshohet kontrata. Për të gjitha këto pika, ajo kërkon përgjigje zyrtare.

Kryetari i Komunës së Drenasit, z. Ramiz Lladrovci, deklaroi se Komuna ka shpallur interes të përgjithshëm për të mundësuar konkurrimin e operatorëve ekonomikë. Ai sqaron se operatorëve nuk mund t'u caktohet zona me metra katrorë, pasi pronat nuk jepen me qira për një afat të shkurtër 11-muajsh, por për periudha afatgjata prej 20, 30, 35, 90 apo 99 vjetësh. Sipas tij, vetë operatorët ofrojnë çmimin e qirasë, numrin e punëtorëve dhe investimin që do të kryejnë, dhe mbi bazën e këtyre kriterëve shpallen fitues.

Lidhur me pronën e kompanisë "ETC" në Komoran, sqaroi se ajo fillimisht u dha nga Komuna dhe iu fal një pronari. Pasi pala kërkoi regjistrimin në emrin e vet, me pretendimin se më parë ishte regjistruar në emër të të vëllait, ajo pronë iu mor përsëri. Ai shton se janë bërë dokumente të falsifikuara, por ai vetë i ka anuluar të gjitha. Kryetari saktëson se as nuk ua ka dhënë ai atë pronë, as nuk ua ka caktuar çmimin dhe as nuk ka qenë pjesë e komisionit, duke ritheksuar se gjithçka ka qenë transparente dhe kjo çështje është hetuar. Ai tha se nuk mund të pretendohet se ka pasur skandal apo se pronat janë dhënë me atë çmim, pasi këtë gjë e ka mundësuar vetë ligji i hartuar nga shteti i Kosovës.

Për kompaninë "IP-Kos", si në Komoran ashtu edhe në Drenas, kryetari pohon se ajo i plotëson të gjitha kriteret, ndërsa ato pika që nuk janë plotësuar janë të evidentuara në raport dhe në rekomandim. Ai shton se gjatë konkurimit, kjo kompani nuk ka aplikuar ekskluzivisht vetëm për shitjen e derivateve.

Sa i përket rastit të biznesit "Bekimi" ku u përmend ndryshimi i pronarit, z. Lladrovci shpjegon se kur një person e merr pronën me qira për 99 vite dhe ndërron jetë, është e natyrshme që ajo t'u

kalojë trashëgimtarëve ligjorë. Ata merren vesh te noteri dhe nuk ka nevojë për hartimin e një kontrate të re. Në përfundim, kryetari deklaroi se për çdo gjë që asambleistët vlerësojnë se përbën shkelje nga ana e ekzekutivit komunal, mund t'i adresojnë ato në Prokurorinë e Kosovës. Lidhur me kompaninë "Fer Petrol", ai bëri të ditur se zyra ligjore e komunës dhe ajo e kompanisë janë duke punuar së bashku për të rregulluar dhe përmirësuar gabimet teknike, dhe kjo çështje do të zgjidhet së shpejti. Ndërkaq, për të gjithë ata operatorë që nuk i plotësojnë kriteret dhe për të cilët komisioni ka rekomanduar shfuqizimin e kontratave, kryetari njoftoi se u është dërguar vendimi për shfuqizim. Meqenëse palët kanë bërë ankesa në gjykatë, priten vendimet e këtyre të fundit dhe shumë shpejt do të arrihet shkëputja e kontratave për t'u kthyer pronat në shërbim të qytetarëve të Komunës.

Egzona Tërdevci, deklaroi se patjetër do t'u drejtohet institucioneve të drejtësisë, pasi beson se ekziston bazë e mjaftueshme për t'i argumentuar këto gjetje. Ajo thekson se nuk mund të konsiderohet si gabim teknik rasti kur një pronë jepet për qendër edukative për komunikacion dhe mbi të ndërtohet pompë derivate, duke shtuar se një situatë e tillë nuk mund të besohet nga asnjëri prej asambleistëve.

Tërdevci tha se për secilën pronë arsyetohet se nuk ka një mënyrë për matjen e investimeve. Ajo ngre pikëpyetje se si mund t'u besohet vetëm deklaratave të kompanive për shumën e investuar, kur ekzistojnë pasqyra financiare përmes të cilave mund të verifikohet çdo investim. Sipas saj, institucionet nuk duhet të mjaftohen vetëm me konstatime vizuale apo me bazë shikueshmërie. Në përfundim, ajo vlerëson se kjo procedurë mund dhe duhet të ndryshojë, si dhe kërkon që raportin të përgatitet përsëri nga fillimi.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, tha se "Fer Petrol"-i, përveç pikave që i ka rreshtuar, ka edhe atë që po përmendni ju, dhe të gjitha janë në suaza të kontratave. Kur të nënshkruhet kontrata, mund ta marrësh e ta dërgosh edhe në prokurori, por nëse del gjithçka në rregull, atëherë vijon një kundërpadi dhe e merr dënimin 100 për qind, sikur ai globi që më ka paditur rrejshëm. Vlerësimi i investimeve është për ata operatorë ekonomikë të cilët i kanë bërë para 20-40 vjetësh. Nuk e kanë në raport kur u është dhënë prona, sepse pronat përpara ti i ke kërkuar 20 ari ose 40 ari. Tash ai po thotë: "Unë i kam kërkuar 40 ari, komuna më ka dhënë 20 ari, dhe unë i kam përcaktuar 40 punëtorë; mirëpo, me 20 ari s'kam ku t'i fus 40 punëtorë". Unë e kam obligim t'i them se mua dhe institucioneve na intereson çfarë ke nënshkruar ti, jo çfarë ke kërkuar ti. Dhe kjo është arsyeja pse kemi telashe me numrin e punëtorëve, pasi nuk po mund të plotësohet numri i tyre.

Drejtori i Gjeodezisë, Arian Krasniqi, i është përgjigjur znj. Tërdevci lidhur me pretendimet për mospagesë, duke sqaruar se gjendja e kartelës financiare ka një defekt teknik, gjë që mund të pasqyrojë gabimisht mungesë të pagesave. Ai specifikoi se i vetmi operator që nuk e ka kryer ende pagesën për vitin 2026 është furra e bukës "Mcha".

Driton Ajazi, theksoi se pas një analize të detajuar të raportit, si Kuvendi ashtu edhe ekzekutivi duhet t'i marrin parasysh shqetësimet e bizneseve, duke qenë se investimet e tyre ndikojnë direkt në zhvillimin e Drenasit. Ajazi bëri thirrje për mirëkuptim institucional dhe gjetjen e një gjuhe të përbashkët me investitorët, veçanërisht në sigurimin e hapësirave adekuate që garantojnë ligjshmërinë e operimit të tyre. Në fund, ai ngriti si shqetësim mungesën e informacioneve në

raport për një pjesë të pronave që kanë qenë në shfrytëzim, duke kërkuar sqarime shtesë nga kryetari i Komunës se çfarë ka ndodhur me to.

Kryetari i Komunës së Drenasit, z. Ramiz Lladrovci, shtoi se nuk dëshiron t'i cilësojë si të kundërligjshme kontratat e trashëguara nga mandatet e kaluara, por nënvizon detyrimin për t'i respektuar ato plotësisht, pavarësisht nëse janë nënshkruar nga ai apo nga paraardhësi i tij. Ai bën të ditur se të gjitha kontratat 10-vjeçare që tashmë kanë skaduar do t'i nënshtrohen përsëri një procesi të ri ligjor. Z. Lladrovci thekson se qëllimi i ekzekutivit nuk është dëmtimi i bizneseve, por insiston që operatorët duhet të jenë aktivë dhe të gjenerojnë punësim. Sipas tij, pronat komunale ndahen ekskluzivisht për zhvillim ekonomik dhe nëse një biznes dështon të zgjerohet e mbetet me vetëm një punëtor, ai nuk është fitimprurës për veten dhe Komuna nuk ka arsye t'ia vazhdojë shfrytëzimin e asaj prone.

Liman Krasniqi kujton se, çdo person juridik që nënshkruan marrëveshje me Kuvendin Komunal i pranon vullnetarisht kushtet e ofruara. Ai sqaron se qëllimi i dhënies së tokës në shfrytëzim është rritja e vlerës së saj, dhe se sipas ligjit, pas përfundimit të afatit (qoftë ai 10 apo 50 vjet), të gjitha investimet dhe të mirat e realizuara në atë pronë i barten automatikisht komunës. Krasniqi porositi konkurruesit që t'i matin mirë kapacitetet e tyre përpara se të aplikojnë. Duke marrë parasysh rënien ekonomike dhe krizën për punëtorë të kualifikuar, ai propozon që Komuna të tregohet më fleksibile me ato biznese që kanë përmbushur përafërsisht vlerën e investimit. Në fund, ai bën thirrje për kujdes të shtuar sa i përket kriterit të numrit të punëtorëve, duke nënvizuar se në rrethanat e tanishme tregtare nuk është e lehtë për bizneset që ta rrisin numrin e stafit.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi, konstatoi se nuk kishte diskutues të tjerë për pikën e kaluar dhe hapi për shqyrtim pikën e gjashtë të rendit të ditës. **Pika (6) Informimin mbi aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për periudhën janar-qershor 2026.**

Xhavit Drenori shprehet se, megjithëse i mirëpret raportet zyrtare pasi i shërbejnë për t'i informuar qytetarët, materiali i prezantuar nga KKSB-ja ishte shumë i shkurtër, i thjeshtëzuar dhe përmbante vetëm të dhëna që tashmë janë publike në ueb-faqen e komunës. Kërkoj që në seanca të tilla të jetë i pranishëm edhe raportuesi përkatës. Ai ngriti si shqetësim mungesën e të dhënave specifike nga policia, siç është rasti me dukurinë e përdorimit të drogës nëpër shkollat e mesme dhe trendet e saj. Në fund, ai nënvizoi se asambleistët ndajnë një pjesë të përgjegjësisë për sigurinë dhe kërkoj që raportet e ardhshme të përfshijnë tema që prekin drejtpërdrejt jetën e qytetarëve.

Nënkryetari i Komunës, Arben Shala, përgjigjet duke sqaruar se materiali i prezantuar është vetëm një raport përmbledhës. Ai shtoi se ekzekutivi ka obligim t'i mbajë gjashtë mbledhje vjetore të ndara në mënyrë të barabartë për të dy gjashtëmujorët, duke nënvizuar se procesverbalet dhe raportet specifike për secilin takim janë tashmë të publikuara në ueb-faqen e Komunës.

Zeqir Hasi, mbështet shqetësimin e ngritur nga Xhavit Drenori, duke e cilësuar raportin si shumë të shkurtër dhe të mangët. Hasi kërkoi pasqyrim më të hollësishëm të gjendjes për të identifikuar burimin e rreziqeve që i kanosen rinisë dhe për të ndërmarrë masat parandaluese me kohë.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ndërhyri duke thënë se, raporti i KKS-së sipas natyrës së tij është i përmbledhur shkurt, ndërsa të gjitha statistikave dhe shqetësimet e ngritura nga asambleistët gjenden të detajuara në raportet ditore dhe javore të Policisë së Kosovës.

Nënkryetari Arben Shala, vuri në dukje se takimet e KKS-së, në bashkëpunim me KLSP-në e Komoranit, kanë rezultuar me fushata të shumta kundër dukurive negative si droga e duhani, duke i ftuar asambleistët që të bëhen pjesë e këtyre aktiviteteve shoqërore.

Xhavit Drenori, deklaroi se nuk e konteston rëndësinë dhe brumin informativ që prodhojnë këto institucione, por shtoi se përfshirja në fushata sensibilizuese varet nga vullneti dhe karakteri i secilit përfaqësues të popullit. Ai theksoi se preferon t'i përpunojë të dhënat zyrtare dhe t'i ndajë ato me 12 mijë ndjekësit e tij në rrjetin social Facebook, si një formë për t'i bërë shërbim komunitetit që e ka votuar.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, tha se pika e gjashtë nuk votohet e hapi për diskutim pikën e shtatë të rendit të ditës. **Pika (7). Propozim vendim për Shfuqizimin e vendimit 02 Nr.020/04-19807 të datës 29.05.2026 për themelimin e komisionit për verifikimin e lejeve ndërtimore nga viti 2017 e deri në vitin 2026.**

Driton Ajazi, deklaroi se grupi i tij është parimisht pro shfuqizimit të vendimit për komisionin e lejeve ndërtimore, me qëllim që të evitohet rrëzimi i vendimeve nga MAPL-ja për shkak të paligjshmërisë. Ai nënvizoi se ruajtja e pikëve në grantin e performancës është vitale, pasi nga këto fonde përfitojnë direkt qytetarët e Drenasit, ndërsa propozoi që komisioni verifikues të rithemelohej në një formë tjetër që është në përputhje të plotë me ligjin.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci tha se, e patë edhe vetë që ky vendim që na është kthyer është i njëjtë me vendimin rekomandues të pronave. Pra, në qoftë se ju doni të bëni komision, unë e bëj komisionin që nga viti 2001. Aty në gjeoportale janë të gjitha të dhënat e investimeve të trojeve dhe i shikojmë të gjitha dalëngadalë. I keni tri vite kohë. Mirëpo, jo të bëhet një hetim selektiv, sepse kjo është e paarsyeshme dhe e padrejtë. Kështu që, nëse dëshironi, më tregoni dhe unë e formoj komisionin që ta bëjë mbikëqyrjen, edhe pse auditori i ka marrë të gjitha mostrat 100% dhe nuk ka gjetur asgjë të parregullt.

Driton Ajazi, deklaroi sepajtohet plotësisht me ju, kryetar, që ajo kërkesë është selektive nëse bëhet vetëm prej vitit 2017, sepse mbulon vetëm kohën prej kur ju keni qenë kryetar. Për ne nuk prish punë që të bëhet një komision i tillë që nga momenti kur janë themeluar institucionet e Republikës së Kosovës. Ashtu siç e çekët edhe ju, ato i ka mbikëqyrur auditori dhe ata janë ekspertë të kësaj fushe, prandaj edhe ne jemi pro një komisioni të tillë gjithanshëm.

Arigon Sinani, e kundërshtoi qëndrimin e Driton Ajazit për shfuqizimin e pikës, duke kërkuar që ajo të mbetet në rend dite dhe të votohet kundër. Sinani hodhi akuza të rënda, duke pretenduar se në Drenas janë bërë keqpërdorime të mëdha me lejet e ndërtimit për pompa të benzinës dhe ndërtesa të larta, duke thënë se biznesmenëve u janë kërkuar ryshfete në kesh apo donacione prej 50 mijë deri në 100 mijë euro për klubin futbollistik "Feronikeli" në këmbim të lejeve ndërtimore.

Liman Krasniqi, propozoi që të mos themelohet një komision i ri nëse Auditori Gjeneral ka nxjerrë tashmë raport për këtë fushë, me arsyetimin se ekspertët e auditimit janë bazuar në ligj dhe asambleistët vështirë se mund të gjejnë shkelje të tjera.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, sqaroi se auditori ka qëndruar pesë javë në Komunë dhe ka kontrolluar 100% të mostrave të lejeve ndërtimore, duke tejkaluar obligimin e tij ligjor. Ai theksoi se, ekzekutivi nuk ka çfarë të fshehtë nga asnjë komision dhe nënvizoi se nëse auditori do të kishte gjetur shkelje të rënda, rasti do të shkonte direkt në prokurori e nuk do të mbetej vetëm në nivel rekomandimesh teknike për voncesat e operatorëve. Po ashtu, Lladrovci u mburr se Drenasi është e vetmja komunë në Kosovë që lëshon leje ndërtimore brenda një afati prej 30 ditësh. Pasi nuk pati diskutime të tjera për pikën e shtatë, **kryesuesi** e hodhi në votim. Për votuan 15, kundër 2, ndërsa pati 6 abstenime.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, hapi për diskutim pikën e tetë të rendit të ditës. **Pika (8)**. Propozim vendim për financimin e projektit për OJQ "Klubi i Futbollit FC Feronikeli 74".

Egzona Tërdevci, deklaroi se, parimisht i mbështet subvencionet, por ngriti shqetësimin për disproporcionin e madh buxhetor, duke vënë në dukje se rreth 93.69% e mjeteve shkojnë për sport, ndërsa kultura dhe rinia mbeten me vetëm 5.5% respektivisht 0.76%. Ajo bëri thirrje për një rimendim të kësaj strategjie shpërndarëse.

Drejtori i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Alban Zogaj, u shpreh se mbështetja financiare për sportin mbetet e ulët karshi suksesit të klubeve sportive që përfaqësojnë imazhin kryesor të Drenasit, siç është rasti me klubin "FC Feronikeli 74" dhe shkollat e tjera të futbollit. Zogaj pranoi faktin se subvencionet për kulturën dhe rininë kanë pasur vlerë më të ulët, mirëko këtë ia faturoi mungesës së ideve dhe projekteve konkurruese që dorëzohen për financim. Në këtë kuadër, ai bëri thirrje se zhvillimi i këtyre sektorëve nuk është vetëm përgjegjësi e drejtorisë që ai udhëheq, por e çdo qytetari të Drenasit, duke premtuar mbështetje maksimale për çdo projekt që propozohet në të ardhmen, ndonëse deri më tani nismat kanë qenë të pakta.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ndërhyri në debat duke sqaruar se, sektori i kulturës ka përlituar mbështetje përmes një kontrate të veçantë me programin ReLOaD. Sipas tij, nga ky fond kanë përfutur pesë organizata joqeveritare një vlerë të konsiderueshme prej 53 mijë eurosh, gjë që përbën rreth 35 deri në 40 për qind të subvencionimit total për këtë fushë. Po ashtu sqaroi se organizatat që kanë siguruar financim nga ky program ndërkombëtar, nuk kanë pasur të drejtë të përfitojnë nga thirrjet e rregullta të brendshme të Komunës.

Egzona Tërdevci u përgjigj duke ritheksuar se kritika e saj nuk lidhej me vlerën e ndarë për futbollin, por me disproporcionin e madh krahasuar me sektorët e kulturës dhe rinisë. Ajo e vlerësoi informacionin rreth projektit ReLOaD, por shprehu keqardhje që nuk ishte njoftuar më herët për këtë marrëveshje. Tërdevci i drejtoi një pyetje zyrtare drejtorit duke kërkuar të dhëna të sakta mbi shumën financiare që Komuna e Drenasit ofron si bashkëfinancim për këto subvencione.

Drejtori i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Alban Zogaj, u përgjigj duke sqaruar se shkalla e bashkëfinancimit nga ana e Komunës së Drenasit është në vlerë prej 30 për qind të kontratës së përgjithshme. Ai specifikoi se nga shuma totale prej rreth 52 mijë eurosh sa peshon projekti, pjesëmarrja financiare e vetë Komunës do të jetë afërsisht 16 mijë euro.

Xhavit Drenori, adresoi gjithashtu shqetësimin e tij lidhur me disproporcionin ndërmjet investimeve në sport dhe në kulturë. Ai ngre disa çështje dhe propozime për fushën e subvencionimit në kuadër të Drejtorisë për Kulturë, Rinë dhe Sport, duke vlerësuar se zhvillimi i një komune nuk matet vetëm me investimet materiale, por edhe me mënyrën e ruajtjes së kulturës, traditës, identitetit dhe mbështetjes së talentëve.

Së pari, dua të ndalem te mënyra e ndarjes së subvencioneve. Nëse e analizojmë strukturën aktuale të përkrahjes financiare, shohim një disbalancë të theksuar, ku pjesa dërrmuese e mjeteve shkon për sportin, ndërsa kultura mbetet me një përqindje shumë të vogël të mbështetjes. Sporti padyshim ka rëndësinë e vet dhe duhet përkrahur, sepse ekipet dhe sportistët tanë e promovojnë komunën tonë. Por, në të njëjtën kohë, nuk duhet harruar se kultura është baza e identitetit tonë. Kemi shoqëri kulturo-artistike, asociacione, krijues, artistë, njerëz të artit dhe të kulturës që kontribuojnë në ruajtjen e trashëgimisë sonë. Prandaj, konsideroj se duhet të bëhet një rishikim i planifikimit buxhetor dhe të krijohet një balancë më e drejtë mes sportit dhe kulturës. Nëse vazhdon kjo përqindje e ndarjes, atëherë duhet ta shtrojmë edhe çështjen e emërtimit të drejtorisë, sepse në praktikë kemi një përqendrim shumë më të madh në sport sesa në kulturë. Propozimi im është që drejtoria ta analizojë këtë situatë dhe ta korrigjojë këtë disbalancë në planifikimet e ardhshme.

Së dyti, dua të flas për manifestimin tradicional 'Sofra Poetike Ymer Elshani'. Ky aktivitet ka një vlerë të veçantë kulturore dhe përfaqëson një pjesë të identitetit tonë letrar e kulturor. Por, nga viti në vit, po shihet një rënie e nivelit të organizimit për shkak të mungesës së një përkrahjeje të qëndrueshme. Kërkoj që ky manifestim të futet si vijë e veçantë buxhetore, në mënyrë që të ketë siguri financiare dhe të mos varet vetëm nga mundësitë momentale të subvencionimit. Një manifestim me këtë emër dhe këtë traditë meriton trajtim institucional.

Së treti, dua të ngre shqetësimin për humbjen e disa aktiviteteve që dikur kanë qenë krenari e komunës sonë. Njëri prej tyre është 'Revista e Folklorit Burimor', një manifestim që kishte rëndësi për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë sonë kulturore. Nuk duhet të lejojmë që aktivitete të tilla të zhduken pa një analizë dhe pa një përpjekje për rikthimin e tyre.

Së katërti, dua të përmend edhe 'Humoriadën', festivalin e humorit që për shumë vite ishte një veçanti jo vetëm për Drenasin, por edhe për skenën kulturore në Kosovë. Ishte një aktivitet që sillte energji pozitive, bashkonte qytetarët dhe promovonte kulturën përmes humorit. Është e rëndësishme të shihet mundësia e rikthimit të këtij festivali. Me siguri, kjo gjë do të rikthente edhe shumë asambleistë në sallën e kulturës.

Së pesti, një çështje tjetër që kërkon vëmendje është promovimi dhe kujdesi për objektet e trashëgimisë kulturore dhe komplekset memoriale. Në një nga mbledhjet e kaluara unë e kam ngritur çështjen e ciceronëve. Komuna jonë ka vende me vlerë historike dhe kulturore, por shpesh mungon një organizim i mirëfilltë për informimin dhe orientimin e vizitorëve. Propozimi im është që të caktohet një zyrtar apo ciceron i angazhuar për këto objekte, i cili do të kujdesej për prezantimin e tyre, për vizitorët dhe për promovimin e vlerave tona. Në fund, kërkoj që këto çështje të mos shihen vetëm si kërkesa individuale, por si një përgjegjësi institucionale për ta zhvilluar kulturën në komunën tonë. Sporti dhe kultura duhet të ecin bashkë, sepse të dyja janë investim në rininë, identitetin dhe të ardhmen e shoqërisë sonë.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, i vlerësoi si të arsyeshme propozimet e asamblëistit Xhavit Drenori, duke sqaruar se ekzekutivi po përpiqet t'i plotësojë këto zbrazëtira kulturore përmes aktiviteteve të organizuara gjatë "Muajit të Mërgatës", me qëllim të krijimit të një ambienti sa më të mirë për bashkatdhetarët. Megjithatë, sa i përket kërkesës specifike për angazhimin e ciceronëve nëpër objektet historike, u shpreh skeptik dhe u deklarua kundër. Ai mori si shembull negativ raste të mëhershme të punësimeve në stacionin e autobusëve, ku sipas tij, punëtorët kanë përfituar paga pa prodhuar asnjë të hyrë financiare për institucionin. Kryetari bëri të ditur se si pasojë e këtyre lëshimeve, Komuna po përballlet me fatura të përmbaruesve që arrijnë vlerën prej 30 deri në 40 mijë eurosh për punë të pakryera, duke përfunduar se Drenasi aktualisht nuk ka kapacitete buxhetore e as mjete të lira për angazhimin e ciceronëve të rinj.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, e hodhi në votim pikën e tetë të rendit të ditës.**Pika (8).** Propozim- vendim për financimin e projektit për OJQ "Klubi i Futbollit FC Feronikeli 74" Për votuan 22, kundër 0, abstenime 0.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, hodhi në votim pikën e nëntë të rendit të ditës.**Pika (9).** Propozim- vendim për financimin e projektit OJQ "Klubi KFF Feronikeli" Femra. Për votuan 22, kundër 0, abstenime 0.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, hodhi në votim pikën e dhjetë të rendit të ditës.**Pika(10).** Propozim- vendim për financimin e projektit për OJQ "Klubi i Futsalit FC "Liqeni" Për votuan 22, kundër 0, abstenime 0.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, hodhi në votim pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës.**Pika(11).** Propozim- vendim për financimin e projektit për OJQ "Shotë Galica". Për votuan 22, kundër 0, abstenime 0.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, hodhi në votim pikën e dymbëdhjetë të rendit të ditës.**Pika(12).** Propozim- vendim për financimin e projektit për OJQ "Klubi i volejbollit Gryka". Për votuan 22, kundër 0, abstenime 0

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, hodhi në votim pikën e trembëdhjetë të rendit të ditës.**Pika (13).** Propozim- vendim për financimin e projektit për OJQ KV "Feronikeli femrat". Për votuan 22, kundër 0, abstenime 0

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, hodhi në votim pikën e katërmbëdhjetë të rendit të ditës. **Pika(14).**Propozim- vendim për financimin e projektit OJQ KV“Feronikeli Meshkujt”. Për votuan 22, kundër 0, abstenime 0.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, hodhi në votim pikën e pesëmbëdhjetë të rendit të ditës. **Pika(15).**Propozim- vendim për financimin e projektit për OJQ “Klubi i Futsallit Drenasi”Për votuan 21, kundër 0, abstenime 1.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, hodhi në votim pikën e gjashtëmbëdhjetë të rendit të ditës.**Pika.(16).**Propozim- vendim për financimin e projektit për OJQ “Klubi i Futsallit Komorani”.Për votuan 22, kundër 0, abstenime 0.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, e hapi për pikën e shtatëmbëdhjetë të rendit të ditës. **Pika(17).**Propozim -vendim për ndarjen e lokacionit në parcelën nr.00523-2 për investime në infrastrukturën sportive dedikuar për sportin e shigjetarisë. Pasi nuk pati diskutime kryesuesi e hodhi në votim pikën e (17) Për votuan 20, kundër 0, abstenime 1.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, hapi për diskutim pikën e tretë të paraparë në rend të ditës. Mirëpo, në mungesë të kryeshefit të KRU "Prishtina" dhe drejtorit të degës në Drenas, fjalën e mori Nexhmedin Gruda.

Drejtori i Shërbimeve Publike, Nexhmedin Gruda, së pari, është e rëndësishme të sqarohen përgjegjësitë institucionale. Legjislacioni në fuqi përcakton qartë se furnizimi me ujë të pijshëm, operimi dhe mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit, si dhe garantimi i vazhdimësisë së shërbimit, janë përgjegjësi e operatorëve të licencuar të ujësjellësit, përkatësisht e Kompanive Rajonale të Ujësjellësit (KRU).

Ligji për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit i obligon këta operatorë të sigurojnë standarde të larta të furnizimit, cilësi të ujit dhe trajtim të rregullt të shërbimeve për konsumatorët. Ndërkohë, Ligji për Vetëqeverisjen Lokale u jep komunave kompetenca në planifikim, në zhvillim të infrastrukturës dhe në investime kapitale, por jo në operimin e drejtpërdrejtë të sistemit të ujësjellësit.

Po ashtu, Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit janë ndërmarrje publike qendrore, aksionare e të cilave është Qeveria e Republikës së Kosovës. Edhe statuti i KRU “Prishtina” e përcakton qartë se veprimtaria kryesore e saj është furnizimi dhe mirëmbajtja e sistemit të ujësjellësit. Prandaj, komunat nuk janë operatorë të shërbimit, por partnerë institucionalë në planifikim dhe investime infrastrukturore.

Në këtë kuadër, është me rëndësi të theksohet edhe angazhimi i Komunës së Drenasit në situata ku është kërkuar ndërhyrje emergjente për të mbrojtur interesin e qytetarëve:

Së pari, pas ndërhyrjeve të KRU “Prishtina” për sanimin e defekteve në rrjetin e ujësjellësit ndër vite, në shumë raste është dëmtuar infrastruktura rrugore. Për shkak të ankesave të shumta të qytetarëve, Komuna është detyruar të përgatisë një Memorandum Bashkëpunimi për sanimin e gropave dhe kthimin në gjendje funksionale të rrugëve, të cilat kishin mbetur të hapura me vite të tëra.

Së dyti, në disa raste është vërejtur mospërbushje e plotë e obligimeve për trajtimin e ujërave të zeza, ndonëse sipas kompetencave kjo është përgjegjësi e operatorit të shërbimit. Megjithatë, për t'u dalë në ndihmë qytetarëve dhe për të parandaluar dëmtimin e mjedisit, Komuna ka intervenuar në raste të caktuara ku kërkohej zgjidhje emergjente.

Së treti, për një periudhë rreth gjashtëmuajore, ka qenë e bllokuar një pusëtë në udhëkryqin ndërmjet rrugëve "Shaban Shala" dhe "Asllan Fazliu", gjë që ka shkaktuar dëmtime në rrugë dhe shqetësim për banorët. Në mungesë të ndërhyrjes në kohë nga ujësjellësi, Komuna e Drenasit ka intervenuar dhe ka realizuar sanimin, edhe pse kjo nuk ishte kompetencë e saj e drejtpërdrejtë. Sipas të dhënave publike, gjatë viteve të fundit KRU "Prishtina" dhe Qeveria e Kosovës kanë realizuar investime të rëndësishme në disa komuna që përfshihen në zonën e tyre të shërbimit.

Liman Krasniqi, merr fjalën në minutën 17:16 por për shkak të mungesës së zërit në regjistrim, pyetja e tij nuk dëgjohet.

Driton Ajazi deklari se, siç e dini ju edhe qytetarët e Komunës së Drenasit, ka qenë një ftesë për mbledhje të jashtëzakonshme për të diskutuar për këtë çështje. Nuk e përshëndes mospjesëmarrjen tuaj në atë mbledhje; është shumë joserioze mospjesëmarrja e përfaqësuesve të KRU "Prishtina". Në këto temperatura të larta, qytetarët e Komunës së Drenasit vuajnë nga mungesa e ujit të pijshëm. Ne jemi përfaqësues të qytetarëve pa dallime politike. Përballë kësaj situate, qytetarët meritojnë përgjigje të qarta dhe profesionale.

Cilat janë arsyet konkrete që kanë shkaktuar mungesën e furnizimit me ujë për një periudhë kaq të gjatë.

Pse nuk është siguruar furnizim i rregullt dhe i pandërprerë, siç obligohet kompania, cilat masa janë ndërmarrë deri më tani për zgjidhjen e problemit dhe pse ato nuk kanë dhënë rezultat.

Kur do të rikthehet furnizimi normal dhe a ekziston një plan konkret me afate të qarta.

Çfarë investimesh janë planifikuar për të parandaluar përsëritjen e kësaj gjendjeje, kush mban përgjegjësi për dëmet dhe vështirësitë që u janë shkaktuar qytetarëve. Për të gjitha këto pyetje duhet të gjejë zgjidhje organi kompetent. Unë kam prit që ka për të ardhur përfaqësuesi kompetent i nëndegës së KRU "Prishtina" në Drenas, Sokol Bylykbashi, për të diskutuar edhe çështjen e furnizimit me ujë në fshatin Sankoc, sepse furnizimi me ujë është ndërprerë për shkak të mospagesës së ujit. Ne kemi pasur takime edhe me përfaqësuesit e fshatit, edhe me të kompanisë.

Atë që thotë kompania qytetarët nuk mund ta bëjnë, sepse kërkesa e kompanisë ka qenë që secili banor të bëjë një shakt jashtë dycerve të oborrit dhe ta vendosë një ujëmatës; pastaj vjen kompania dhe bën verifikimin, e nënshkruajmë kontratën dhe u lëshojmë ujin. Për qytetarët kjo nuk bëhet. Unë kisha kërkuar nga kompania për këtë veprim, qytetarët janë të gatshëm të bashkëpunojnë për këtë çështje dhe unë u qëndroj prapa. Le të vijnë ata, le t'i rregullojnë shaktet dhe le t'i vendosin orët matëse, dhe secili qytetar do t'i nënshkruajë kontratat individualisht për shfrytëzimin e ujit në fshatin Sankoc.

Liman Krasniqi shpreh zhgënjimin që drejtori i njësisë së Drenasit nuk është i pranishëm për të dhënë një raport konkret. Ai i drejton një pyetje Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë (DSIPE) nëse ka informacione për shkaqet e mungesës së ujit, sasinë e ujit që vjen deri te filtrat në rezervuarët e Feronikelit, kapacitetin e filtrave dhe raportin me ujit të përpunuar dhe nevojave të popullatës. Ai propozon që në zonat qendrore dhe në objektet kollektive në Drenas të

zbatohen reduktime të planifikuara. Po ashtu, ai pyet Drejtorin e Urbanizmit nëse mjetet e grumbulluara nga renta e tokës ndërtimore mund të destinohen për zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit dhe rritjen e kapacitetit të filtrave në bashkëfinancim me kompaninë.

Mehedin Salihu, shpreh keqardhje për largimin e asambleistit Xhavit Drenori nga salla dhe thekson se Kuvendi Komunal është institucioni i vetëm ku duhet të diskutojhet kjo problematikë, e jo nëpër kafene apo oda. Ai vë në dukje mospërputhjen mes premtimeve të para gjashtë muajve për dyer të hapura 24 orë dhe realitetit aktual. Në fund, ai kërkon një përgjigje të shkurtër dhe të qartë nga drejtori se përse ka mungesë të ujit dhe kur pritët të rikthehet furnizimi.

Pajtime Berisha, e cilëson çështjen e ujit si problemin më serioz që shqetëson banorët, duke veçuar situatën në Poklek të Ri, Poklek të Vjetër dhe Vasilevë. Ajo denoncon faktin se në fshatin Vasilevë nuk është investuar asnjë metër gyp në rrjet. Znj. Berisha kërkon që Komuna e Drenasit të kërkojë llogari urgjente nga KRU "Prishtina" për shkaqet e kësaj gjendjeje dhe kërkon investime urgjente e afatgjate në rrjet që banorët të kenë furnizim të sigurt.

Egzona Tërdevci, deklaroi se çështja e ujit mbetet një shqetësim i përbashkët për asambleistët dhe qytetarët, të cilët çdo ditë përballen me mungesë furnizimi. Ajo sqaron se e ka takuar rastësisht kryeshefin e kompanisë, i cili i ka konfirmuar pranimin e ftesës, mirëpo arsyet e mospjesëmarrjes së tij në seancë mbeten të panjohura. Znj. Tërdevci saktëson se flesa ndaj kryeshefit ishte për qëllim informimi dhe jo raportimi zyrtar, pasi Komuna e Drenasit nuk zotëron aksione në KRU "Prishtina".

Sipas informacioneve të saj nga niveli qendror, ajo bën të ditur se tashmë është nënshkruar marrëveshja për riparimin e një pompe, e cila pritët të fillojë shumë shpejt dhe të lehtësojë furnizimin, ndërsa dy pompa të tjera janë në proces e sipër. Ajo shton se avokimi dhe investimet e tilla janë në të mirën e përbashkët. Ndërkaq, znj. Tërdevci drejton një pyetje nëse Komuna ka bërë ndonjëherë kërkesë zyrtare apo adresim për gjendjen e pompave, duke qenë se ato janë mjaft të vjetra, që nga viti 1985. Ajo pranon se Komuna ka investuar në shtrirjen e rrjetit, mirëpo vë në dukje se edhe kompania e ujësjellësit ka asistuar në hartimin e projekteve detaje për këto investime. Në fund, ajo kërkon sqarime mbi pengesat dhe arsyet se pse nuk po realizohet mbushja e rezervuarit të Kamenicës.

Zeqir Hasi, mbështet pikat e potencuara nga parafolësit dhe thekson se bizneset vendore ndodhen në kolaps si pasojë e mungesës së ujit. Ai bën thirrje që Komuna të shqyrtojë hapat e menjëhershëm që mund të ndërmarrë për t'u siguruar ujë qytetarëve, pa pasur nevojë për drejtim gishtash apo fajësime të ndërsjella. Po ashtu, z. Hasi kërkon që ekzekutivi të dalë me një komunikatë zyrtare për të treguar afatin e saktë të rregullimit të pompës, me qëllim që edhe asambleistët të kenë informacione të qarta për t'ua përcjellë qytetarëve.

Luljeta Elshani, ngriti shqetësimin e banorëve të fshatit Krajkovë, të cilët përballen me mungesë serioze të ujit të pijshëm. Ajo njofton se rreth 80% e fshatit mbetet pa furnizim të rregullt, ndonëse rrjeti i ujësjellësit është tërësisht i shtrirë në atë zonë. Sipas banorëve, problemi kryesor qëndron te mungesa e mirëmbajtjes së pompave ekzistuese. Për këtë arsye, znj. Elshani kërkon nga Komuna e Drenasit dhe kompania e ujësjellësit që ta trajtojnë këtë rast me prioritet,

të inspektojnë gjendjen në terren dhe të funksionalizojnë pompat për të garantuar furnizim të qëndrueshëm, duke nënvizuar se uji është një e drejtë themelore.

Edon Nishori, e cilësoi vepër të ulët mungesën e kryeshefit të KRU "Prishtina", e aq më pak edhe të njësisë në Drenas, që vjen nga një parti përgjegjëse. Ai ngrii disa çështje në zonën nga unë vij. Në Komoran 2, në atë që ne e quajmë "Te Çukat", është rezervuari dhe sa herë që shterret, punëtori i KRU-së duhet të vijë manualisht për t'ia hequr ajrin; për shkak të moslargimit të ajrit, ajo zonë nuk ka fare ujë. Pastaj, në Komoran 3, ku janë të lidhur rreth 50% e banorëve, si dhe në lagjen e Dobroshevcit (te rruga "Ymer Alushani"), ka pasur shumë dëmtime gjatë punimeve të kompanive të ndryshme dhe gypat janë tërësisht të dëmtuar; do të ishte mirë që të rregulloheshin. Po ashtu, edhe ajo pjesë që janë të lidhur, ujë kanë vetëm natën e nuk kanë ditën. Ndërsa në Komoran 4 janë të vendosura orat, por nuk janë të lidhur njëhisorë, banorët aty janë të gatshëm t'i kryejnë të gjitha pagesat dhe obligimet e nevojshme.

Tringa Bujupi, parashtoi një pyetje të qytetarëve të lagjes së Xhamisë në fshatin Arllat, të adresuar për Drejtorin e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, z. Endrit Gllareva. Ajo kërkon të dijë arsyet se pse ende nuk ka filluar asfaltimi i rrugicave në këtë lagje, përkundër kërkesave të vazhdueshme me shkrim ndër vite dhe gatishmërisë së banorëve për të bashkëpunuar me procesin e shpronësimit dhe respektimin e kriterëve ligjore. Ajo kërkon një afat të qartë dhe një ndërhyrje konkrete për këtë çështje.

Muhamet Xhemaili, e cilëson situatën e ujit si emergjente dhe u drejton një pyetje kryetarit të Komunës dhe drejtorit përkatës nëse ekziston ndonjë projekt alternativ buxhetor. Ai kërkon të dijë nëse Komuna ka planifikuar ose ka mundësi të zhvillojë ndonjë projekt për ndërtimin e ndonjë baze apo liqeni akumulues artificial për rezerva të ujit, me qëllim që në të ardhmen Komuna të mos varet ekskluzivisht nga KRU "Prishtina" apo nga zonat e tjera të jashtme.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci tha se, po ju drejtohem juve, qytetarë të Drenasit. Çështja e furnizimit me ujë është ekskluzivisht detyrë e KRU 'Prishtina', të cilën e ka certifikuar **Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU)** dhe e ka pajisur me licencë për furnizim me ujë të qytetarëve, ndër të tjerë edhe të Drenasit. Unë nuk kam licencë nga ARRU-ja për të shitur apo për të blerë ujë.

Edhe kur ndodhin vërshimet, menaxheri i ujësjellësit e ka obligim të jetë pjesë e shtabit emergjent, por ai asokohe nuk ka ardhur. Ujin është dashur t'ua sigurojmë qytetarëve me ndihmën e donatorëve, përdorisa ujësjellësi e ka pasur obligim. Ju vetëm më tregoni se çfarë të bëjmë për të dalë nga kjo situatë, dhe unë jam i gatshëm të bëj gjithçka që është brenda ligjit, e jo jashtë tij.

Unë u kërkoj falje atyre qytetarëve ku nuk kemi mundur ta shtrijmë rrjetin — si në Vasilevë apo diku tjetër — edhe pse kjo nuk është përgjegjësi imja. Të gjitha gjërat nga komuna, ne i kemi bërë dhe tashmë ato janë në dorë të operatorit KRU 'Prishtina', që është përgjegjësi e nivelit qendror. Ata nuk kanë ardhur në mbledhje sepse nuk kanë çfarë të thonë. Më tregoni, cilin investim e kanë sjellë në Drenas për ujin e pijshëm. Cilin burim uji e kanë marrë përsipër? Asnjë! Këta duhet ta dinë që është detyrim ligjor të ketë ujë të pijshëm për qytetarët me të cilët kanë kontratë.

Neve na duhet ujë që hyn në gypa direkt nga burimi dhe që nuk turbullohet sa herë që ka reshje, sepse për dy javë rresht nuk kemi pasur ujë pikërisht për shkak të reshjeve. Vetëm më tregoni se ku nuk i kam kryer unë obligimet e mia. Unë jam këtu për t'u përballur.

Drejtori i Shërbimeve Publike, Nexhmedin Gruda, ofron dy sqarime zyrtare. Së pari, në përgjigje të interesimit të z. Krasniqi, ai bën të ditur se pas komunikimit me përfaqësuesit e kompanisë së ujësjellësit, problemi kryesor qëndron te jofunksionaliteti i pompave në Bivolak. Njëra prej tyre është dërguar për riparim me një afat prej 30 ditësh, ndërsa aktualisht operon vetëm një pompë dhe sasia e saktë e prurjes nuk dihet. Sa i përket kapacitetit të filtrave, kompania ka deklaruar se ai është i mjaftueshëm, mirëpo ka mungesë të lëndës së parë (ujit), gjë që pamundëson edhe mbushjen e rezervuarit në Gllobar.

Së dyti, lidhur me defektin e shfaqur pranë rrethrotullimit në një thellësi prej katër metrash, z. Gruda njofton se ai është sanuar plotësisht përmes kompanisë së kontraktuar nga Komuna dhe rrjeti është kthyer në gjendje funksionale. Ai shton se ekzistojnë shkresat zyrtare elektronike (e-mailat) që dëshmojnë ftesën e dërguar përfaqësuesve të KRU "Prishtina", mirëpo këta të fundit kanë dështuar të koordinohen për të siguruar pjesëmarrjen në seancë.

Egzona Tërdevci, i drejtohet kryetarit duke i propozuar që të lihet anash krenaria personale dhe deklaratat politike ndërmjet institucioneve. Ajo vlerëson se palët duhet të ulen e të bisedojnë, pasi zgjidhja e problemit të ujit është shumë më prioritare sesa interesat apo krenaria e secilës palë që refuzon të raportojë apo të informojë. Ndërsa pranon se kompetenca e Komunës kufizohet vetëm në shtrirjen e rrjetit dhe jo në furnizim, ajo sqaron se defekti i përmendur nga drejtori ka ardhur si pasojë e bllokimit nga asfalti, pasi është asfaltuar drejtpërdrejt mbi pusetë, duke vënë në dukje se ky nuk është rasti i parë i kësaj natyre.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, u përgjigjet se nuk udhëhiqet nga krenaria, mirëpo konsideron se nuk ka arsye të kërkojë takime me palë që dëmtojnë vazhdimisht Komunën e Drenasit përmes mosfurnizimit dhe që refuzojnë të marrin pjesë në mbledhje zyrtare. Ai kujton se ekzekutivi ka realizuar disa vizita zyrtare në zyrat e kompanisë dhe njofton se janë ndarë 200 mijë euro, të cilat janë në dispozicion për t'u orientuar sipas nevojave, ndonëse janë të parapara për vitin e ardhshëm buxhetor.

Ai theksoi se Komuna nuk ka nevojë për udhëzime nga menaxhmenti i kompanisë se si të ndërhyhet apo si të riparohen pompat në Krajkovë, por insiston në sigurimin e paktën të dy orëve ujë në ditë për qytetin. Ai tha se probleme të këtij niveli nuk kanë ekzistuar në vitet e kaluara dhe kërkon sërish të identifikohen mundësitë për ndërhyrje emergjente, pasi ekzekutivi i ka shqyrtuar të gjitha opsionet e mundshme.

Driton Ajazi, thekson se diskutimi për mungesën e ujit mbetet jetik dhe asnjëherë i tepërt derisa të arrihet zgjidhja përfundimtare. Pas dëgjimit të të gjitha shqetësimeve, ai propozon si masë konkrete që gjatë rishikimit të buxhetit të ndërmerren ndërhyrje me kosto të ulët në rrjet në ato fshatra ku ekziston mundësia praktike. Ajazi specifikon se fshatrat si Sankoc, Krajkovë, Llapushnik, Arllat dhe Gjergjicë posedojnë burimet e tyre vetjake të ujit, prandaj përmes një investimi të përballueshëm financiar mund t'u rikthehet furnizimi i rregullt banorëve.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi konstatoi se, pasi nuk pati diskutime të tjera, e konsideroi të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoi në orën 16:46.

Procesmbajtësja: Fakete Hoti

Lekturoi: Nikelinda Bujupi



Kryesuesi i Kuvendit

Burim Bujupi



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Komuna/Opstina/Municipality Drenas (Glllogoc)
Zyra e Kryetarit



01 Nr. 400/01-28780 Dt. 15/07/2026

RAPORTI FINANCIAR JANAR - QERSHOR 2026

KORRIK 2026

1. Hyrje dhe baza Ligjore

Raporti financiar buxhetor, për periudhën Janar – Qershor 2026, është përgatitur në pajtim me dispozitat e nenit 45, paragrafët: 45.2, 45.4 dhe 46.1 të Ligjit, nr. 03/L – 048, për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Raporti i përgatitur nga Kryetari i Komunës mbulon periudhë Janar – Qershor të vitit fiskal 2026 dhe paraqet informatat që kanë të bëjnë me arkëtimin e të hyrave vetanake, shpenzimet dhe të dhënat mbi investimet kapitale.

1.1. Performanca e të hyrave

Gjatë periudhës **janar–qershor 2026**, të hyrat e përgjithshme janë realizuar në vlerë prej **1,138,900.43 €**, ndërsa në të njëjtën periudhë të vitit 2025 vlera e arkëtuar ishte prej: **1,340,451.09 €**. krahasuar me vitin paraprak, është evidentuar një **rënjë prej: 201,550.66€** - përkatësisht **11,77 %**.

1.2. Performanca e shpenzimeve

Gjatë periudhës **janar–qershor 2026**, shpenzimet e përgjithshme të komunës janë realizuar në vlerë prej **11,869,529.14 €**, ndërsa në të njëjtën periudhë të vitit 2025 ato ishin **10,284,173.51 €**. Krahasuar me vitin paraprak, është shënuar një **rritje prej 15.42%**, respektivisht **1,585,355.63 €** më shumë. Në raport me buxhetin e planifikuar për vitin 2026 prej **23,734,533.00 €**, realizimi i përgjithshëm i shpenzimeve arrin në **50.01%**, që paraqet një nivel të kënaqshëm të realizimit për gjashtëmujorin e parë të vitit.

Shpenzimet operative

Shpenzimet operative janë realizuar në vlerë prej **8,956,893.74 €**, krahasuar me **7,129,106.41 €** në periudhën e njëjtë të vitit 2025. Kjo paraqet një **rritje prej 25.64%**, ndërsa realizimi ndaj buxhetit të planifikuar për vitin 2026 është **55.58%**. Rritja e kësaj kategorie tregon intensifikim të aktiviteteve operacionale dhe funksionim normal të institucioneve komunale gjatë gjashtëmujorit të parë.

Paga dhe shtesat

Në kategorinë **Paga dhe shtesa** janë shpenzuar **7,557,680.01 €**, ndërsa në vitin 2025 ishin realizuar **5,968,684.16 €**. Kjo paraqet një **rritje prej 26.62%**, ndërsa realizimi i buxhetit për këtë kategori ka arritur në **57.59%**. Rritja vjen edhe prej ekzekutimit të pages së **13-të** e cila nuk ka qene e planifikuar për vitin 2026.

Mallrat dhe shërbimet

Shpenzimet për **Mallëra dhe shërbime** janë realizuar në vlerë prej **1,131,107.56 €**, krahasuar me **1,013,488.92 €** në vitin paraprak, duke shënuar një **rritje prej 11.61%**. Shkalla e realizimit të buxhetit për këtë kategori është **43.73%**, duke treguar se një pjesë e konsiderueshme e furnizimeve dhe kontratave të planifikuara pritet të realizohet gjatë gjashtëmujorit të dytë. Nga kjo kategori e shpenzimeve vlera prej **370,834.66 €** janë ekzekutuar për vendime gjyqësore (kontratat kolektive).

Shpenzimet komunale

Shpenzimet komunale janë realizuar në vlerë prej **268,106.17 €**, krahasuar me **146,933.33 €** në të njëjtën periudhë të vitit 2025. Kjo përfaqëson **rritjen më të lartë ndër të gjitha kategoritë**, prej **82.47%**, ndërsa realizimi ndaj buxhetit është **66.06%**. Nga kjo kategori e shpenzimeve vlera prej **23,297.54 € janë ekzekutuar për vendime gjyqësore (kontratat kolektive)**.

Subvencionet dhe transferet

Në kategorinë **Subvencione dhe transfere** janë realizuar **234,574.10 €**, ndërsa në vitin 2025 ishin realizuar **271,151.93 €**, duke shënuar një **ulje prej 13.49%**. Realizimi ndaj buxhetit vjetor është **31.55%**, çka tregon se pjesa më e madhe e subvencioneve dhe transfereve është planifikuar të ekzekutohet gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit.

Shpenzimet kapitale

Shpenzimet kapitale janë realizuar në vlerë prej **2,678,061.30 €**, krahasuar me **2,883,915.17 €** në vitin 2025, duke shënuar një **ulje prej 7.14%**. Realizimi ndaj buxhetit të planifikuar prej **6,875,138.00 €** është **38.95%**. Niveli më i ulët i realizimit në gjashtëmujorin e parë është karakteristik për projektet kapitale, pasi shumica e tyre zhvillohen dhe përfundojnë gjatë pjesës së dytë të vitit, pas përfundimit të procedurave të prokurimit dhe fillimit të punimeve. Nga kjo kategori e shpenzimeve vlera prej **300,647.07 € janë ekzekutuar për vendime gjyqësore (kontratat kolektive)**.

Analiza e realizimit të shpenzimeve për periudhën **janar-qershor 2026** tregon se komuna ka realizuar **50.01% të buxhetit vjetor**, duke ruajtur një dinamikë të mirë të ekzekutimit të buxhetit. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2025, shpenzimet e përgjithshme janë rritur për **15.42%**, kryesisht si rezultat i ekzekutimit të pages së 13-të dhe vendimeve gjyqësore për kontrata kolektive.

Sa i përket **buxhetimit gjinor** mund të themi se përqindja e femrave në listën e të punësuarve arrin në **56.3 %** dhe buxheti i pagave i shpenzuar për këtë kategori ka shkuar në këtë përqindje të shpenzimit. Gjithashtu në periudhën Janar-Qershor komuna ka ndarë subvencione për lehonat dhe shërim rreth **58,718.00 €**, 3 bursa **1.500 €** (bursiste femra). Pjesa tjetër e subvencioneve është shpenzuar për shërbime të varrimit **33,200.00 €** dhe transportit **74,532.70 €**.

Të hyrat vetanake për tremujorin e dytë të vitit 2026 dhe krahasimi me vitet paraprake

Përshkrimi	2024	2025	2026	Krahasuar 2026/ 2025(%)
	në Euro			
1. GJITHSEJ TË HYRA	926,385.40	1,340,451.09	1,138,900.43	84.96
Të hyrat direkte	716,073.69	786,794.09	618,311.43	78.59
Të hyrat Indirekte	210,311.71	553,657.00	520,589.00	94.03
1.1. Të hyrat nga kodi 16301	28,468.37	22,070.95	22,091.50	100.09
Taksa për certifikata (50013-50016)	23,745.00	18,396.00	18,430.00	100.18
Taksa për verifikimin e dokumenteve të ndryshme (50017)	1,848.87	661.46	359.50	54.35
Vert.Fotok.dokumentacionit (50018)	390.00	139.99	183.5	131.08
Kerkesat 50019	2,484.50	2,873.50	3,118.50	108.53
1.2.Të hyrat nga kodi 16601	8,524.60	18,235.50	12,552.00	68.83
Gjobat nga inspektorati 50104	8,524.60	18,235.50	12,552.00	68.83
1.3.Të hyrat nga kodi 17501	293,029.65	361,110.97	254,672.48	70.52
Tatimi në pronë 40110	227,162.65	287,485.97	173,736.48	60.43
Tax për regjistrimin e automjetit 50001	65,867.00	73,625.00	80,936.00	109.93
1.4. Të hyrat nga kodi 18001	1,009.50	1,007.00	1,243.50	123.49
Tax për parki.nga Sh.Publike 50008	1,009.50	1,007.00	1,243.50	123.49
1.5.Të hyrat nga kodi 18161	0	0	4,297.00	0.00
Tax për leje ndertimi 50009	0	0	4,297	0.00
Të hyrat nga kodi 47001	0	0	292.00	0.00
Taksa të tjera administrative 50019	0	0	292.00	0.00
1.6.Te hyrat na kodi 48001	45,225.70	42,310.00	15,520.00	36.68
Licenca për aktivitete individuale dhe profesionale të lira (50201)	45,225.70	42,310.00	15,520.00	36.68
1.7.Të hyrat nga kodi 65005	65,259.05	58,377.00	77,948.50	262.95
Taksa për ndërrim të pronarit të tokës 50011-50012	33,754.50	25,280.00	13,599.00	53.79
Tax fletposeduese kopje planit. 50032	8,115.50	3,876.00	6,945.00	179.18

Qiraja nga pronat publike 50408	22,799.00	29,013.00	52,818.50	182.00
Matje gjeodezike 50504	590.00	208.00	4,586.00	4246.30
1.8.Të hyrat nga kodi 66310	230,291.32	232,742.08	180,496.50	77.56
Taks per leje ndertimi 50009	217,982.70	168,578.34	127,621.17	74.47
Taks per legalizim te objektev 50026	601.73	1,641.15	3,870.09	241.04
Shfrytzimi I pronës Publike 50405	11,645.89	6,085.84	34,537.19	567.59
Tax per ndrrim te tokës 50012	61.00	56,436.75	14,468.05	25.64
1.9.Të hyrat nga kodi 73100	21,958.00	23,855.69	18,185.41	76.23
Qiraja nga prona publike 50408	0.00	135.69	2,434.41	1794.10
Participimi shendetësi 50409	21,958.00	23,720.00	15,751.00	66.40
2.0. Te hyrat nga kodi 85001	86.50	142.00	261.00	183.80
Qiraja nga vendosja e objektev tregtare 50407	86.50	80.00	0.00	0.00
Qiraja nga prona publike 50408	0.00	62.00	261.00	420.97
2.1. Te hyrat nga kodi 92210	22,221.00	26,377.40	30,069.25	114.00
Participimi Arsimi	22,221.00	26,377.40	30,069.25	114.00
2.1. Te hyrat nga kodi 93000	0.00	565.50	682.29	120.65
Të hyra nga viti I kaluar 61000	0.00	565.50	682.29	120.65
2.1 Të Hyrat Indirekte	210,311.71	553,657.00	520,589.00	94.03
Gjobat e gjykatave	28,032.71	44,628.00	31,382.00	70.32
Gjobat e komunikacionit	182,279.00	509,029.00	489,207.00	96.11
1.7.3 Donacion	0.00	0.00	0.00	0.00

Shpenzimet për periudhën janar– qershor 2026 dhe krahasimi me vitet paraprake

Përshkrimi	2024	2025	2026	Buxheti për vitin 2026	% e shpenzimit
Vitet	1	2	3	4	Me vitin 2025
2. GJITHSEJ SHPENZIMI	9,222,996.65	10,284,173.51	11,869,529.14	23,734,533.00	115.42
Shpenzimet operative	7,300,793.89	7,129,106.41	8,956,893.74	16,115,895.00	125.64
2.1.1 Paga dhe mëditje	6,448,081.87	5,968,684.16	7,557,680.01	13,123,475.00	126.62
2.1.2. Mallra dhe shërbime	731,659.71	1,013,488.92	1,131,107.56	2,586,570.00	111.61
2.1.3 Shpenzime komunale	121,052.31	146,933.33	268,106.17	405,850.00	182.47
2.2 Subvencione dhe transfere	92,209.62	271,151.93	234,574.10	743,500.00	86.51
2.3 Shpenzime kapitale	1,829,993.14	2,883,915.17	2,678,061.30	6,875,138.00	92.86

Subvencionet për periudhën janar-qershor 2026 dhe krahasimi me vitet parapake

Përshkrimi	2024	2025	2026	% me
	Shumat në Euro			2025
Zyra e kryetarit	0.00	3,000.00	4,000.00	133.33
DSIPE	31,175.00	39,782.14	33,200.00	83.45
D.Bujqësisë	30,000.00	28,825.00	49,523.40	171.81
D.Zhvillimit ekonomik	5,757.62	-	-	-
D.Kulturës	4,777.00	128,350.00	13,100.00	10.21
Drejtoria e Shëndetësisë	17,000.00	70,694.79	58,718.00	83.06
Drejtoria e Arsimit	3,500.00	500.00	76,032.70	15,206.54
Gjithsej	92,209.62	271,151.93	234,574.10	86.51

Shpenzimet në projekte kapitale për periudhën janar-qershor 2026

Kodi i projektit	Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimet TM-2/2026	Mbetja	Progresi i
					TM-2/2026 në %
1		2	3	4=2-3	5=3/2
16301	Administrata dhe personeli				
47919	Veture Zyrtare	100,000.00	8,140.00	91,860.00	8.14
	Totali	100,000.00	8,140.00	91,860.00	8.14

Kodi i projektit	Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimet TM-2/2026	Mbetja	Progresi i
					TM-2/2026 në %
1		2	3	4=2-3	5=3/2
18001	DSHPE				
53330	Rreg.dhe rrethimi I varrezave Drenas dhe Komoran	20,000.00	-	20,000.00	-
53341	Zgjerimi i kamerave Drenas dhe Komoran	10,000.00	9,772.76	227.24	97.73
53364	Rregullimi dhe zgjerimi I vendndaljev dhe mbulimi I tyre	5,000.00	-	5,000.00	-
	Totali	35,000.00	9,772.76	25,227.24	27.92

Kodi i projektit	Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimet TM-2/2026	Mbetja	Progresi i
					TM-2/2026 në %
1		2	3	4=2-3	5=3/2
18161	Drejtoria e Infrastruktures Publike				
48254	Rregullimi I shtratit të lumit Drenica dhe Verbica	35,000.00	11,000.00	24,000.00	31.43
48632	Asfaltimi I rrugës Gllanasellë, Godanc	20,000.00	20,000.00	0.00	100.00
48635	Asfaltimi I rrugës Paklek I vjeter, I Ri, Vasilevë	80,000.00	-	80,000.00	-
48638	Asfaltimi I rrugës Dobroshec, Çikatovë e vjeter	120,000.00	-	120,000.00	-
48643	Asfaltimi i rruges ne fshatrat Gradicë dhe Likoshan	50,000.00	50,000.00	0.00	100.00

48646	Asfaltimi rruges Arllat Negroc Gjergjic Bytyq	93,000.00	-	93,000.00	-
48648	Asfaltimi I rruges Sankoc Fushticë	50,000.00	-	50,000.00	-
48653	Asfaltimi I rruges Shtuticë, Verboc, Polluzhë	100,000.00	1,500.00	98,500.00	1.50
48656	Asfaltimi I rruges Llapushnik, Poterk Vukoc	50,000.00	-	50,000.00	-
48658	Asfaltimi I rruges Z. ulët, Lartë K. e ulet dhe e lartë	50,000.00	-	50,000.00	-
48661	Ndertimi I kapaciteteve të ujësjetësit Drenas	600,000.00	487,970.32	112,029.68	81.33
48682	Bashkfinancim projektsh me donator te jashtem	25,000.00	-	25,000.00	-
49297	Zgjerimi dhe ndertimi I sheshit Fehmi c Xheve Lladrovci Dr.	751,802.79	536,737.26	215,065.53	71.39
49299	Asfaltimi I rruges Llapushnik Berish	2,000.00	-	2,000.00	-
51324	Asfaltimi I rrugve Tersteniku I,II dhe Gllobar	100,000.00	50,000.00	50,000.00	50.00
51340	Asfaltimi I rruges Baicë Krajkovë Damanek Shtrubullovë	50,000.00	-	50,000.00	-
52309	Ndërtimi I Rrugës Bregut te Çiqavicës	2,000.00	-	2,000.00	-
52310	Ndërtimi I parkut dhe shtigjet për Këmbësor	50,402.00		50,402.00	-
53631	Ndërtimi I Kolektorve për grumbullimin e ujërave te zeza	120,446.00	-	120,446.00	-
53635	Rregullimi I Trotuarve dhe ndriqimit Publik	720,000.00	335,000.00	385,000.00	46.53
53645	Asfaltimi I rrugëve dhe Kubzimi Drenas I,II,III,IV	320,000.00	63,989.18	256,010.82	20.00
53652	Asfaltimi I rrugëve Komorani I,II,III,IV	20,000.00		20,000.00	-
53659	Ndërtimi I Tombinave dhe mureve mbrojtëse	50,000.00	13,970.09	36,029.91	27.94
53660	Ndërtimi zgjerimi dhe rikonstruimi I rrugëve të asfaltuara	415,000.00	115,000.00	300,000.00	27.71

53666	Ndertimi, zgjerimi i rrjetit të kanalizimit	250,000.00	149,999.99	100,000.01	60.00
53670	Asfaltimi i rrugëve Abri dhe Tërdec	20,000.00		20,000.00	-
53672	Asfaltimi i rrugëve Nekoc Kizhnarekë	50,000.00	-	50,000.00	-
53674	Hapja e kanaleve Kulluese gjatë rrugëve Drenas Komoran	50,000.00	-	50,000.00	-
54100	Ndertimi i rrugëve fushore ne Komunën e Drenasit	269,965.00	261,689.63	8,275.37	96.93
54104	Ndertimi i rruges tranzit Drenas-Kroi i Mbretit	5,000.00	-	5,000.00	-
54108	Ndertimi i digës për ujëmbledhës në fshatin Verboc	2,000.00	-	2,000.00	-
54266	Rregullimi i inf.ne parkun e pishave ne Komoran- Fushticë	80,000.00	-	80,000.00	-
55568	Rehabilitimi i rruges dhe ndertimi i trotuarit Arllat-Negrovc dhe Vuçak	2,000.00	-	2,000.00	-
40	Ekzekutimi i Vendimeve Gjyqesore	301,605.00	300,347.07	1,257.93	
Totali		4,905,220.79	2,397,203.54	2,508,017.25	48.87

Kodi i projektit	Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimet TM-2/2026	Mbetja	Progresi i
					TM-2/2026 në %
	1	2	3	5=2-3	6=3/2
47001	Bujqësia				
	Grant i donatorve te brendshem	2,213.32	-	2,213.32	-
	Totali	2,213.32	-	2,213.32	-

Kodi i projektit	Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimet TM-2/2026	Mbetja	Progresi i TM-2/2026 në %
------------------	------------	---------	----------------------	--------	---------------------------

	1	2	3	4=2-3	5=3/2
73100	Sherbimet e shendetesis primare				
49181	Paisje speciale mjeksore mbi 1000	10,000.00	2,945.00	7,055.00	-
55574	Ndertimi I QMF-se Arllat	100,000.00	-	100,000.00	-
55575	Rregullimi I oborreve dhe rrethojave te QKMF.QMF dhe AMF Arllat Sankoc Abri,Dobroshec dhe Vasileve	10,000.00	-	10,000.00	
	Totali	120,000.00	2,945.00	117,055.00	-

Kodi i projektit	Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimet TM-2/2026	Mbetja	Progresi i TM-2/2026 në %
1	2	3	4=2-3	5=3/2	
75502	Sherbimet Rezidenciale				
54131	Ndertimi I shtepise per komunitete - sherbime komuale per persona me aftesi te kufizuara	230,000.00	-	230,000.00	-
	Totali	230,000.00	-	230,000.00	-

Kodi i projektit	Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimet TM-2/2026	Mbetja	Progresi i TM-2/2026 në %
1	2	3	4=2-3	5=3/2	
85001	Drejtoria e Kulturës 85001				-
89114	Ndertimi I stadionit faza e dyte	340,000.00	160,000.00	180,000.00	47.06
20712	Ndërtimi I fushave sportive Komoran,Korroticë e Eperme dhe Arllat	122,000.00		122,000.00	-
	Totali	462,000.00	160,000.00	302,000.00	34.63

Përshkrimi	Buxheti	Mbetja	Progresi i
------------	---------	--------	------------

Kodi i projektit			Shpenzimet TM-2/2026		TM-2/2026 në %
	1	2	3	4=2-3	5=3/2
93000	Arsimi Fillor				
51325	Dixhitalizimi I institucioneve arsimore ne Drenas	100,000.00	-	100,000.00	-
54209	Instalimi I nxemjeve qendrore-riparimi I kulmit ne SHFMU"Xheladin Gashi -plaku" Komoran	110,918.00	-	110,918.00	-
54212	Ndertimi I SHFMU "Rasim Kiqina" Drenas paralele e ndare ne Shtrubullova	300,000.00	-	300,000.00	
55604	Ndertimi I aneksit te shkolles "Arif Shala" dhe "Naim Frasheri"	175,000.00	100,000.00	75,000.00	
20703	Ndertimi I parkingjeve ne shkolla "G.Elshani, A.Shala, A.Bejta, Xh.Gashi, B.Curri, D.Drenices, L.Gurakuqi, Rilindja, A.Bujupi, 24 Korriku	40,000.00	-	40,000.00	
20704	Ndertimi I rrethojave te fushave te jashtme sportive ne Sh.Galica, A.Bejta, G.Sylaj dhe D.Forteset	35,000.00	-	35,000.00	
20705	Ndertimi I rrethojave te oborreve te shkollave H.Prishtina, F.Grajqevci. dhe M.Gradica	40,000.00	-	40,000.00	
20707	Ndertimi I pjerrinave ne hyrje te objekteve shkollore per PAK,Shtutice,Dobroshec,Gllanasell dhe Gllabar	10,000.00	-	10,000.00	
20708	Trafo per furnizim te objektit te qerdhes " Ardhmeria"	32,000.00	-	32,000.00	
20709	Instalimi I nxemjeve qendrore me pelet ne Gj.Kastrioti Skenderbeu, R.Kiqina, A.Gashi, Z.Hajdini, F.Lladrovi	50,000.00	-	50,000.00	
20710	Furnizimi I Shkollave me tabela te menqura dhe paisje percjellese	110,000.00	0	110,000.00	0

20711	Ndertimi I shkalleve emergjente ne shkollat fillore ne Komunen e Drenasit, B.Curri,R.Kiqina, Z.Hajdini , Migjeni, Gj.K.Skenderbeu, a.Bujupi, H.Bajraktari	20,000.00	-	20,000.00	-
Totali		1,022,918.00	100,000.00	922,918.00	-

611	Totali KOMUNA	6,875,138.79	2,678,061.30	4,197,077.49	38.95
-----	---------------	--------------	--------------	--------------	-------

Kryetari i Komunës



Ramiz Lladroveci

[Handwritten signature]